



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Turizëm”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë
“Eqrem Çabej”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Çlirim Duro

Dr. Nevila Çinaj

Shtator/2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në “Turizëm”**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Turizëm”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 795, datë 06.10.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR Nr. 5348/1 date 12.06.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.125, dt.29.03.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë: Master Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti: 2020-2021 10 PAE/ 1 PAK 2021-2022 11 PAE/ 0 PAK 2022-2023 10 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve:	Nr. Stud. Viti: 2020-2021 13 2021-2022 9 2022-2023 10
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në “Turizëm” ofrohet nga Universiteti “Eqrem Cabej”, Gjirokastrë. Njësia kryesore ku bën pjesë ky program studimi është Fakulteti i “Ekonomisë” dhe Njësia Bazë që e ofron këtë program studimi është Departamenti i “Politikave Ekonomike dhe Turizmit”. Programi është licensuar me VKM nr. 795, datë 06.10.2010 dhe riorganizuar me Shkresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5348/1, datë 12.06.2018.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i “Ekonomisë” përbëhet nga 3 Departamente:

1. Departamenti Administrim Publik,
2. Departamenti Kontabilitet -Financë,
3. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit

Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të dytë Master Profesional në “Turizëm” dhe synon të përgatisë profesionistë të fushës së turizmit me standarde të larta bashkëkohore. Ky program studimi është hartuar për të siguruar formim të profilizuar, në gjendje që i diplomuari të veprojë me aftësi dhe pavarësi profesionale në fushën e turizmit si dhe të sigurojë profesionistë të rinj që t’i shërbejnë vendit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në Universitetin “Eqrem Cabej” Gjirokastrë u përgatit nga dy profesorë me përvojë dhe ekspertë të fushës: Prof.As. Çlirim Duro dhe Dr. Nevila Çinaj Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga koordinatoreja teknike e ASCAL, Msc. Rajna Lila.

Ekspertët e vlerësimit bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UGJ dhe në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, kanë kryer vlerësimin e jashtëm për programin e studimit Master Profesional në “Turizëm”. Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastrë për akreditimin dhe zhvilloi vizitën në ambientet e tij në datat 20-21 Nëntor 2023.

Gjatë këtyre ditëve u zhvilluan takime me përfaqësues të këtij institucioni, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Departamentin e Politikave Ekonomike dhe Turizmit, grupin e punës dhe stafin e programit për të kuptuar dhe pyetur më tej në lidhje me vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit të studimit.

Takime u zhvilluan dhe me studentët e programit të studimit, si dhe zyrat administrative të Sekretarisë mësimore, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit si dhe në Bibliotekën e Universitetit.

Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar për gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport dhe kanë rënë dakord për vlerësimin e standardeve sipas rubrikave përkatëse. Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për programin e studimit Master Profesional në “Turizëm”, ofruar nga Universitet “Eqrem Cabej” Gjirokastrë.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Turizëm”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni ofron programin Master Profesional në “Turizëm” me qëllim marrjen e njohurive të thelluara në këtë program studimi, kjo argumentohet në koherencë me kërkesat e tregut të punës, si dhe nevojën në thellimin e njohurive të studentëve që kanë mbaruar ciklin Bachelor. Njohuritë e përfituara në këtë fushë studimi i përgjigjen interesit kombëtar. Ky program studimi mbështetet në studimet në fushën e Turizmit, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, të Fakultetit të Ekonomisë dhe ekzaktësisht të Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Turizmit. <i>Evidencë 1.1 Statuti i UGJ</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi mbështetet në strategjinë e Institucionit të UGJ si dhe në strategjinë e Njësisë Kryesore duke zbatuar konkretisht qëllimet në lidhje me fushën e studimit, në fushën e turizmit. Ky program studimi përmbush qartazi objektivat strategjike të institucionit, të Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Turizmit që ofron këtë program studimi Master Profesional në “Turizëm”. UGJ dhe Fakulteti Ekonomik synojnë të ofrojnë një formim të plotë në fushën e turizmit me qëllim dhënien e aftësive të nevojshme për mundësinë e punësimit në tregun lokl, rajonal dhe me gjerë. <i>Evidencë 1.1 Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë 1.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 3. Programi i	Në strategjinë e UGJ, theksohet rëndësia e përmirësimit të rritjes

studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	së cilësisë së programit të studimit. Sipas vizitës në institucion dhe shqyrtimin e dokumentave të institucionit, ky program studimi plotëson nevojat e kërkesat e tregut për profesionistë të tregut në fushën e turizmit. Ky program studimi ka në qendër formimin e specialistëve, ekspertëve të kësaj fushe, duke i pajisur me njohuritë e kualifikimet e duhura me synim plotësimin e kërkesave të tregut. <i>Evidencë 1.1 Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë 1.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare. Programi është në përputhje me vizionin, si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi studimi. Departamenti konsideron si prioritet progresiv evoluimin dhe forcimin e studentit, i cili pas përfundimit me sukses të ciklit të parë të studimit pajiset me diplomë universitare “Master” në “Turizëm” ky student është i aftë të mbulojë një shërbim profesional të specializuar në turizëm dhe mund të punësohet në sektorë publik e privat, ku lind nevoja e menaxhimit dhe përdorimit të sistemeve të ndryshme bashkëkohore duke u përshtatur më së miri edhe me teknologjitë inovative. MP në Turizëm dhe strategjia e zhvillimit të tij është hartuar në përputhje me programin e studimit dhe argumentohet që realizohet në përputhje me vizionin dhe strategjinë e interesat kombëtare si dhe mbi fokusin global të zhvillimit kombëtar përshkruar në ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. <i>Evidencë 1.1 Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë 1.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Ky program studimi ofrohet në dakordësi të plotë me interesat kombëtare si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UGJ.</i> <i>Programi ofrohet bazuar në aktet ligjore e nënligjore si dhe aktet</i>

	<i>e hartuara dhe miratuara nga vet institucioni. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni referon që ka burimet e duhura në fushën akademike, si dhe për fushën specifike. Nga dokumentacioni i depozituar, duket që institucioni ka kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij program studimi. Referuar vizitës që GVJ zhvilloi në institucion dhe pasi mori informacion të hollësishëm mbi këtë program, mund të themi se ky institucion i ka kapacitetet dhe burimet e duhura në këtë fushë akademike. <i>Evidencë I.7 Urdhri i hapjes UGJ.</i> <i>Evidencë I.9 Certifikata e Akreditimit Institucional</i> <i>Evidencë Tabelat Përmbledhëse (Tab. 16)</i> <i>Evidencë III.3 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Për programin e studimit Institucioni referon se, MP në "Turizëm" fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A; B; C; D dhe E. Kategoria A: Lëndë bazë/përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme Kategoria B: Lëndë karakterizuese/përgatitje për disiplinën shkencore Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese/grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. Kategoria D: Lëndë plotësuese/gjuhë të huaja, njohuri

	informatike, praktika profesionale Sipas vendimit 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. “Mbi Procedurën për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, programi është pajisur me kodin përkatës sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane nën kodin 72MP0311S. <i>Evidencë I.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidencë I.3 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për Kodifikimin e programeve FE</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit MP në Turizëm referohet që është një program i cili i përgjigjet fushës specifike të programit të Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Turizmit dhe fusha e studimit referohet që është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit të kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve Kombëtare e Evropiane. <i>Evidencë I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit</i> <i>Evidencë I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për Kodifikimin e programeve FE</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	<i>Institucioni nuk ofron një rast të tillë.</i>
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme	Institucioni ofron trajnime dhe workshope të ndryshme për studentët falë bashkëpunimeve që UGJ ka me institucione të ndryshme. Një aktivitet i rëndësishëm është Impact Week ku

për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	morën pjesë përfaqësues shumë të rëndësishëm në fushën e biznesit. Një tjetër bashkëpunim shumë i suksesshëm dhe me një rëndësi të vecantë për studentët është marrëveshja me Ambasadën e SHBA ku studentët do të mund të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. <i>Evidencë II.4 Work and Travel</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e MP në "Turizëm". Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën kërkimore të Njesisë Kryesore si dhe të Njesisë Bazë. GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni referon se, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, UGJ siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrative financiare e institucionit, pasqyrohet në analizën vjetore institucionale. Sipas takimit të zhvilluar me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe asaj Bazë, bashkëpunimi dhe asistimi është një nga themelet kryesore të funksionimit të këtij Institucioni. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik përcaktohen edhe në marrëveshjet e nënshkruara në fillim të vitit akademik mes drejtuesit të njesisë bazë dhe pedagogut lidhur me ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, kontribut institucional etj. Institucioni analizon në mënyrë të vazhdueshme punën, sipas detyrave të ngarkuara dhe realizimit të tyre nga ana e personelit të njesisë bazë dhe të njesisë kryesore.

	<i>Evidencë 1.1 Statuti I UGJ</i> <i>Evidencë 1.14 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2019-2020</i> <i>Evidencë 1.14.2 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2020-2021</i> <i>Evidencë 1.14.4 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2021-2022</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Sipas dokumenteve shoqërues të RVB dhe vizitës në institucion, konstatohet se Departamenti në bashkëpunim me Fakultetin kanë nënshkruar marrëveshje reciproke me institucione të rëndësishme në vend si publike edhe private në nivel universiteti dhe fakulteti, për realizimin e objektivave kryesorë të procesit mësimor e formues të studentëve. Institucioni mundëson leksione të hapura nga lektorë apo përfaqësues specialistë në fushën e programit nga institucione publike dhe private. Këto aktivitete janë në linjë me kërkesat e tregut dhe në përputhje me Strategjinë për Zhvillimin Kombëtar, duke përmirësuar edhe kurrikulat e programit të studimit. Qëllimi i këtyre bashkëpunimeve është pasurimi dhe përmirësimi i ofertës akademike dhe nxitja e kërkimit shkencor. Aktivitetet e kryera gjatë vitit akademik pasqyrohen edhe në raportet vjetore të institucionit. <i>Evidencë 1.14 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2019-2020</i> <i>Evidencë 1.14.2 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2020-2021</i> <i>Evidencë 1.14.4 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2021-2022</i> <i>Evidencë Tabelat përmbledhëse</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,	Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e programit të studimit me institucione publike dhe private në vend. Praktikrat profesionale zhvillohen në terren, në ambientet e institucioneve bazuar në profilin dhe interesin e studentit. Gjithashtu, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që UGJ ka me universitete të huaja, janë realizuar disa mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ për personelin akademik dhe studentët.

praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<i>Evidencë 1.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i> <i>Evidenca 1.20 Lista e mobiliteteve të UGJ</i> <i>Takimi me Dekanin dhe Drejtuesin e Departamentit</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	UGJ e në mënyrë të veçantë njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione apo biznese, në funksion të realizimit të programit të studimit. Në zbatim të marrëveshjeve, interesi ka qenë reciprok, si nga ana e UGJ ashtu edhe nga ana e kompanive apo e institucioneve për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme. Studentët e këtij program studimi, kanë patur mundësi të marrin informacion, apo edhe të punësohen në këto institucione. I gjithë ky proces bashkëpunimi ka qenë në qendër të analizave për përfitimet nga ky bashkëpunim. UGJ harton raporte vjetore në kuadër të përfitimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit. <i>Evidencë 1.14 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2019-2020</i> <i>Evidencë 1.14.2 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2020-2021</i> <i>Evidencë 1.14.4 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2021-2022</i> <i>Evidencë Tabelat përmbledhëse</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Institucioni siguron marrëdhënie të përshtatshme bashkëpunimi, duke përcaktuar detyrat e personelit akademik dhe statusin e tyre.</i> <i>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione publike edhe private në nivel universiteti dhe fakulteti, për realizimin e objektivave kryesorë të procesit mësimor e formues të studentëve. Marrëveshjet e nënshkruara nga institucioni për programin e studimit Master Profesional në "Turizëm", mundësojnë edhe zhvillim të praktikës së detyruar profesionale pranë ambienteve të këtyre institucioneve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MP në Turizëm pëmban të gjithë elementet e strukturës së programit të studimit të përcaktuara në aktet e veprimtaritë formuese, të vlerësuara ligjore e nënligjore përkatësisht dhe konform Ligjit Nr. 80/2015, Neni 33, në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Pika 3 në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në Statusin e UGJ, në rregulloren e brendshme të UGJ-së, të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Turizmit. Programi i Studimit MP në Turizëm është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Bazuar në vendimin Nr. 41, dt 24.01.2018. Lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Plani mësimor përfshin leksione, seminare, praktikë profesionale, provime si dhe zhvillimin e mikrotezës. Totali i krediteve (ETCS) është 120 ETCS. Kohëzgjatja është 2 vite akademike, me katër semestra, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në suplementin e diplomës dhe në rregulloren e programit të studimit. Gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe. <i>Evidencë Tabelat përmbledhëse (Tab. 9) Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndorë (Syllabuset)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe	Programi i studimit synon të realizojë formimin e plotë për specialistët e ardhshëm në fushën e turizmit. Synim i rëndësishëm për këtë program studimi është të rrisë kompetencat profesionale të studentëve. Këtij synimi i shërben edhe përfshirja e lëndëve të ndryshme koherente që lidhen me profilin e turizmit, marketingut, menaxhim etj.

parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<i>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Është parashikuar një ngarkesë prej 12 ETCS për praktikën profesionale. Plani mësimor i programit të studimit MP në Turizëm ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale. Projekti i Diplomimit është një element i rëndësishëm i programit të studimit ku studentit i caktohet një udhëheqës i cili është kompetent për ecurinë dhe zhvillimin e projektit të kërkimit. Në fund të procesit të projektit të kërkimit, pasi mbikëqyrësi kryen vlerësimin, studenti prezanton tezën duke ju përmbajtur specifikave të Rregullores së Fakultetit dhe Rregullores së Universitetit. <i>Evidencë Tabelat Përmbledhëse</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	<i>Institucioni nuk ofron një rast të tillë.</i>
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e	

mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	<i>Institucioni nuk ofron një rast të tillë.</i>
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit MP në Turizëm është hartuar në përputhje me Ligjin "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nr. 80/2015, datë 22.07.2015. Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, stafi i ftuar dhe e gjithë infrastruktura e ndërtuar dhe e mirëkruar është në mbështetje cilësore të këtij procesi mësimdhënie dhe mësimnxenie që reflektohet në kërkesën në rritje që tregu ka për këtë diplomë, e cila nga ana tjetër mbështetet dhe furnizohet me atë cka prodhojnë analizat dhe studimet e tregut duke reflektuar me një feedback të shëndetshëm në përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit mësimor. Marrëdhëniet me bizneset dhe institucionet efektive në tregun vendas e bën më të kërkuar këtë diplomë. Studentët pranohen sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kriterëve shtesë universitare në Republikën e Shqipërisë. <i>Evidencë I.1 Statuti</i> <i>Evidencë II.1 Rregullore e Studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë II.17 Vendim SA për kuotat 2022-2023 dhe kriteret e pranimit 2022-2023</i>

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit MP në Turizëm që ofrohet në ciklin e dytë Master, është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit. Programi i studimit nuk është i ngjashëm me programe të tjera të cilat ofrohen brenda dhe jashtë vendit. <i>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit</i>			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Ky program i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. (KSHK). <i>Evidencë I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FE</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Programi i studimit MP në Turizëm (i përket nivelit 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) përmban të gjithë elementet e strukturës së programit të studimit të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Programi i studimit ka ngjashmëri me programe të njëjta të cilat ofrohen brenda dhe jashtë vendit ndërsa secila lëndë ka numër kreditesh specifik.</i> <i><u>Sugjerohet që përmbajtja e programit të studimit të jetë i ngjashëm me programe të tjera të cilat ofrohen brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që të lehtësohet shkëmbimi i studentëve dhe njohja e diplomës jashtë vendit.</u></i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Evidentohet se Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit është përgjegjës për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore sipas nenit 25, të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 80/2015. Fakulteti Ekonomik në UGJ, si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka angazhuar gjatë vitit 2022-2023 /22 personel akademik me kohë të plotë, 10 personel akademik me kontratë dhe 3 personel ndihmës akademik. FE përbëhet nga 3 njësi bazë (duke përmbushur përcaktimet ligjore përkatëse): • Departamenti Administrimit Publik, • Departamenti Kontabilitet -Financës, • Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit është njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit. Ai funksionon dhe organizohet sipas akteve rregullatore të UGJ dhe në veçanti të rregullores së departamentit. Gjatë vitit akademik 2020-2021, <u>Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit</u> ka angazhuar 6 anëtarë të personelit akademik: • 5 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 3 me gradën “Doktor”, 1 PAK nga të cilët 1 me Dr, Tabela Përmbledhëse, tabela 2. Gjatë vitit akademik 2021-2022, Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit ka angazhuar 4 personel akademik: • 4 PAE, nga të cilët 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 3 me gradën “Doktor”, Tabela Përmbledhëse, tabela 2. Gjatë vitit akademik 2022-2023, Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit ka angazhuar 5 personel akademik: • 4 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 2

	me gradën “Doktor”, 1 PAK me titullin Dr ; Tabela Përmbledhëse, tabela 2. <i>Numri i personelit akademik që i përket kategorisë “Profesor” është i ulët dhe departamenti duhet të bëjë përpjekje për angazhimin e një numri më të madh pedagogësh nga kjo kategori.</i> UGJ i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional duke ju përmbajtur kërkesave ligjore në vitin 2021. <i>Të dhënat për Departament i Politikave Ekonomike dhe Turizmit:</i> <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>3</td><td>1</td><td>3</td><td>--</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td></td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Totali</td><td>5</td><td>1</td><td>4</td><td>0</td><td>4</td><td>1</td></tr></table> <i>Evidencë Tabelat përmbledhëse (Tab. 1 dhe Tab. 2)</i> <i>Evidencë I.9 Vendim i Akreditimit Institucional periodic.</i>	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	2	-	1	-	2	-	Dr./PhD.	3	1	3	--	2	1	Msc.	-	-	-		-	-	Totali	5	1	4	0	4	1
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-																																											
Prof. Asoc.	2	-	1	-	2	-																																											
Dr./PhD.	3	1	3	--	2	1																																											
Msc.	-	-	-		-	-																																											
Totali	5	1	4	0	4	1																																											
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Institucioni referon se praktikat profesionale për studentët e programit të studimit MP në Turizëm, janë të organizuara konform Rregullores së Studimit. Dokumentohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e këtij programi angazhon një personel ndihmës akademik me karakter mësimor për realizimin e punëve në laborator. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, Fakulteti Ekonomik: ● gjatë vitit 2020-2021 ka angazhuar 2 personel ndihmës akademik; ● gjatë vitit 2021-2022 ka angazhuar 2 personel ndihmës akademik; ● gjatë vitit 2022-2023 ka angazhuar 3 personel ndihmës																																																

	akademik			
	<i>Evidencë II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e Njesisë Bazë</i> <i>Evidencë Tabelat Përmbledhëse</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të dokumentave dhe sipas vizitës në institucion konfirmohet se roli i koordinatorit për programin e studimit mbulohet nga Drejtuesi i Departamentit, i cili mban komunikim të vazhdueshëm me Dekanin e Fakultetit si dhe është në komunikim të vazhdueshëm me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit. Drejtuesi përgatit programin e lëndëve të ofruara dhe shpërndarjen e orëve mësimore për pedagogët e departamentit në bashkëpunim me Dekanin. Pra shpërndarja e orëve dhe e lëndëve bëhet në përputhje me natyrën e lëndëve, nevojat e departamentit dhe profilizimet e stafit përkatës, të jashtëm dhe të brendshëm. <i>Evidencë II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e Njesisë Bazë</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit është përgjegjës për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi duke angazhuar edhe personel ndihmës akademik.</i> <u><i>Rekomandohet që për këtë program studimi të caktohet një koordinator i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit.</i></u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për këtë program studimi është njësia bazë përgjegjëse, Departamenti NJBPET dhe FE disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, për strukturën dhe përmbajtjen e tij. I gjithë informacioni rreth këtij programi qarkullon, ruhet, arshivohet në bazë të akteve rregullatore të institucionit. Edhe në faqen zyrtare të UGJ mund të gjendet çdo informacion i vlefshëm për mirë funksionimin e këtij program studimi. Njësia kryesore dhe bazë disponojnë rregulloret përkatëse, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit. <i>Evidencë 1.1 Statuti i Universitetit</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)2022-2023</i> <i>Evidencë II.5.1 Programet Lëndore (Syllabuset)2021-2022</i> <i>Evidencë II.5.2 Programet Lëndore (Syllabuset)2020-2021</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Njësia bazë, është përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MP në Turizëm. Programi ka gjithsej 120 kredite. Programi është i ndarë në 4 semestra. Lëndët janë të ndara në module të ndryshme sipas karakterit të disiplinës (A-E). Informacion po ashtu i detajuar gjendet edhe në syllabuset e lëndëve. Njësia kryesore/bazë, është përgjegjëse, për ndarjen e ngarkesës mësimore dhe mbarëvajtjen e saj. <i>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)2022-2023</i> <i>Evidencë II.5.1 Programet Lëndore (Syllabuset)2021-2022</i> <i>Evidencë II.5.2 Programet Lëndore (Syllabuset)2020-2021</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe	Në përfundim të ciklit të studimit 2 vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare “Master Profesional” në “Turizëm”. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që synojnë këtë program studimi. Këto informacione kryesisht lidhen me kriteret e përgjithshme e specifike të pranimit, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Në fillim të programit, studentët takohen me anëtarët e departamenteve dhe në

ekuivalentimit të studimeve.	fillim të çdo kursi ka një sesion të specifikuar hyrës të krijuar posaçërisht që pedagogët të ofrojnë një shpjegim rigoroz të planprogramit, rendin akademik të kursit, komponentëve të vlerësimit dhe afatet, literatura dhe paketat softuerike të aplikueshme dhe komponentë të tjerë të rëndësishëm siç janë specifikuar në planprograme. <i>Evidencë II.16 Vendim SA për Kuotat 2021-2022 dhe kriteret e pranimi 2021-2022</i> <i>Evidencë II.16.1 Kuotat e propozuara 2020-2021</i> <i>Evidencë II.16.3 Raport i verifikimit të kapaciteteve pritëse</i> <i>Evidencë II.17 Vendim SA për Kuotat 2020-2021 dhe kriteret e pranimi 2022-2023</i> <i>Evidencë II.17.1 Kuotat e propozuara 2021-2022</i> <i>Evidencë II.17.3 Raport i verifikimit të kapaciteteve pritëse 2021-2022</i> <i>Evidencë II.17.4 Vendim SA për Kuotat 2022-2023 dhe kriteret e pranimi 2023-2024</i> <i>Evidencë II.17.5 Kuotat e propozuara 2022-2023</i> <i>Evidencë II.18 Vendim SA për Kuotat 2023-2024 dhe kriteret e pranimi 2024-2025</i> <i>Evidencë II.18.1 Kuotat e propozuara 2023-2024</i> <i>Evidencë II.18.3 Raport i verifikimit të kapaciteteve pritëse 2023-2024</i> <i>Evidencë II.20 Procedurë e transferimit në FE</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në syllabuset e paraqitura, të programit të studimit shihet se ato përmbajnë informacionet e nevojshme për lëndën përkatëse (syllabuset janë të detajuara) për secilën lëndë. Në përgjithësi syllabuset janë të unifikuara për sa i përket objektivave, temave të lëndës së bashku me çështjet për secilën temë, vlerësimin e studentit dhe literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar. Syllabusi i prezantohet studentëve nga instruktori i lëndës në fillim të lëndës duke dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm rreth tematikave të lëndës, orëve në auditor dhe jashtë auditorit si dhe mënyrën e vlersimitë. <i>Evidencë II.2 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit</i>

	<i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Institucioni referon se përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga pala e interesuar. Ai shqyrtohet nga Departamenti dhe Sigurimi i Brendshëm i Cilësis, dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit dhe i përcillet Senatit për miratim të mëtejshëm. Si rregull, rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik dhe jo në mes të vitit akademik apo pasi ai të ketë filluar. Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>			
Konkluzione	<i>I gjithë informacioni për programin e studimit është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Programi i studimit përmban të gjithë elementët përfshirë planin mësimor, modulet, syllabuset etj. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin	Institucioni referon se për përmirësimin dhe përshtatjen e

e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	programit të studimit me kërkesat e tregut të punës njësia bazë merr në konsideratë informacionet e marra nga takime me institucionet akademike, vendase dhe të huaja si në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Studimi i tregut, panairët që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, i shërbejnë këtij synimi. Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme, me qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacion për këto mundësi edhe përmes aktiviteteve të përbashkëta që zhvillon institucioni UGJ. <i>Evidencë II.25 Analiza e tregut të punës</i> <i>Evidencë II.27 Pjesëmarrje në panair Ëork and Study 2022</i> <i>Evidencë II.27.1 Pjesëmarrje në panair Ëork and Study 2023</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Përfshirja e studentëve në strukturat e ndryshme si dhe në komisionet që ngrihen është një detyrim ligjor. Pjesëmarrja e studentëve në Senatin Akademik u jep atyre mundësinë të propozojnë përmirësime të programit të studimeve. Qëndrimi dhe mendimi i studentëve në lidhje me përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi është i mundur edhe përmes pyetësorëve që organizohen nga strukturat e UGJ apo edhe fakulteti dhe departamenti. Pyetësorët, si instrumente matëse të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve, shërbejnë përmes të dhënave të tyre, për të nxjerrë probleme e sugjerime në lidhje me programin e studimit dhe përmirësimin e tij. UGJ mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, konsultohet me ta rreth problematikave të programit të studimit, përmirësimit të kurrikulave, për të ndihmuar Departamentin në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, të lidhjes së formimit teorik me atë praktik, duke u referuar edhe eksperiencave të fituara tashmë në punë prej tyre. Informacioni e lidhja me studentët e diplomuar merret përmes takimeve, konferencave, mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me Alumni të këtij fakulteti e programi studimi. <i>Evidencë I.30 Statuti i Këshillit Studentor</i> <i>Evidencë II.29.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik</i> <i>Evidencë VI.4 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të</i>

	<i>Cilësisë</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti në bashkëpunim me institucione publike e private, në zbatim të marrëveshjeve me to, përmirëson, përditëson programin e studimit në përputhje me kërkesat e nevojat e tregut, në përputhje me kërkesat e institucioneve publike dhe private, duke përfshirë përfaqësues të tyre në mësimdhënie, në leksione të hapura sipas fushës së studimit të këtij programi studimi. <i>Evidencë I.18 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UGJ</i> <i>Evidencë II.28 Impakt Eëek 2023</i> <i>Evidencë II.27 Pjesëmarrje në panair Eëork and Study 2022</i> <i>Evidencë II.27.1 Pjesëmarrje në panair Eëork and Study 2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni raporton se përditëson programin e studimit në bazë të nevojave të tregut duke përfshirë instrumenta të ndryshëm përfshirë këtu pyetësorët për studentë. Studentët me përfaqësimin e tyre në Senatin Akademik kanë mundësinë e dhënies së mendimeve dhe sugjerimeve përsa i përket përmirësimit të programeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Prioritet i programit të studimit është formimi i studentëve të aftë për të qënë kompetent në fushën e tyre. Programi përcakton qartë prioritetet dhe përgjegjësitë në menaxhimin e situatave komplekse jo vetëm si profesionistë por objektivat kryesorë të studimit edhe me vlera të larta humane. Misioni i këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve në fushën e turizmit. Programi ka për objektiv të rrisë kompetencat profesionale të specialistëve të kësaj fushe nëpërmjet njohjes më të plotë të punës pranë institucioneve me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. <i>Evidencë 1.1 Statuti</i> <i>Evidencë 1.3 Strategjia e zhvillimit</i>

	<i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia Kryesore si dhe Njësia Bazë realizon kërkim shkencor në bazë të fushës së vet si dhe duke respektuar etikën në kërkimin shkencor. Personeli akademik në UGJ ka liri në mësimdhënie si dhe në veprimtari kërkimore shkencore. Njësia organizon dhe administron procesin akademik duke nxitur, bashkërenduar dhe respektuar lirinë akademike të stafit që shprehet në tematikat e lëndës, literaturës etj. Dekani i Fakultetit ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit të programit. Shpërndarja gjatë vitit akademik e orëve të teorisë dhe projekteve kërkimore dhe praktikave bën të mundur ndërthurjen e dijeve dhe siguron mundësinë për të respektuar lirinë akademike të pedagogut, duke ndihmuar studentët në mbledhjen e të dhënave për të prezantuar raste konkrete të hasura në fushën e studimit, në projektet e tyre lëndore. <i>Evidencë 1.1 Statuti</i> <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Institucioni referon që Departamenti nxit studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca, seminare dhe workshope si dhe të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, nëpërmjet detyrave të kursit, dhe hartimit të temave të ndryshme kërkimore. Sipas rregullores së Departamentit, studenti ka të drejtë të përdorë, sipas rregullave përkatëse, të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron institucioni për të realizuar programin mësimor. Produktet shkencore të studentëve, si dhe temat e kursit, depozitohen në mënyrë elektronike dhe të printuar pranë departamentit. <i>Evidencë I.19.1 Lista e projekteve të FE</i> <i>Evidencë II.26 Impakt Eëek 2023, Gjirokastra, Albania</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështet	Institucioni UGJ angazhohet në mbështetjen e aktiviteteve kërkimore dhe studimore duke e përfshirë edhe në hartimin e projekt-buxhetit të Institucionit. Institucioni mundëson edhe botimin e aktivitetit shkencor të personelit në Periodikun e tij.

financiarisht nga institucioni dhe administrojnë të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<i>Evidencë II.29 Strategjia për kërkimin shkencor në Universitetin "Eqrem Çabej" 2020-2025</i> <i>Evidencë I.1 Statuti i UGJ</i> <i>Evidencë I.19.1 Lista e projekteve të FE</i> <i>Evidencë II.30 Lista e botimeve në periodikun e UGJ-së</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: Prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë. Njësitë realizojnë kërkim shkencor në bazë të fushës së vet si dhe duke respektuar etikën në kërkimin shkencor. Studentët përfshihen në aktivitete kërkimore shkencore ndërsa stafi raporton mungesë mbështetje financiare për kërkimin shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni referon se mbledhja e të dhënave kërkimore të studentëve në funksion të detyrave lëndore mbështet projektet e lëndëve dhe që plotësojnë kuadrin e objektivave të masterit. Projektet kërkimore-shkencore kryhen në struktura mbështetëse dhe departamente të tjera dhe që sigurojnë bashkëpunimin me strukturat e tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Personeli akademik është i angazhuar në projekte kërkimore-shkencore të financuara nga fondet e Institucionit, AKKSHI ose Erasmus +. <i>Evidencë I.3 Strategjia e zhvillimit të FE</i> <i>Evidencë I.19.1 Lista e projekteve të FE</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon	Institucioni referon se Departamenti angazhohet për të lidhur dhe për t'iu përgjigjur marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me aktorë të rinj të veprimtarisë shkencore, kërkesave për analiza, studime dhe projekteve me karakter kërkimor. Personeli akademik realizon modele bashkëpunimi afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata. Paralelisht, Njësia inkurajon pedagogët të marrin pjesë

personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	në mobilitete afatshkurtra jashtë vendit përmes programit Erasmus+. Përmes këtij programi një numër i konsiderueshëm i stafit akademik ka zhvilluar mobilitete jashtë shtetit gjë që i ka ndihmuar ata në aktivitetin kërkimor. <i>Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ</i> <i>Evidencë I.19 Lista e projekteve të UGJ</i> <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Mbështetur në Tabelën 19 dhe 20 DPET në bashkëpunim edhe me njësi të tjera të UGJ dhe vetë insitucionin, realizon konferencave ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale si dhe organizon aktivitete të ndryshme të cilat ndihmojnë personelin akademik dhe studentët. Studentët kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme trajnuese ndërsa personeli ka mundësinë të marri pjesë në leksione të hapura si dhe aktivitete të ndryshme. <i>Evidencë Tabelat përmbledhëse (Tab.19) dh Tab. 20</i> <i>Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Referuar tabelës 23, të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar dhe të punësuar, institucioni referon se programi i studimit formon profesionistë konkurrues në fushën e turizmit duke i bërë studentët të aftë për tregun kombëtar dhe gjithashtu të synojnë edhe tregun ndërkombëtar të punës. Këtë e tregon dhe numri i të punësuarëve në përputhje me diplomën, 4 nga 6 studente për vitin akademik 2022-2023 dhe 6 nga 11 për vitin akademik 2021-2022. <i>Evidencë Tabelat përmbledhëse (Tab.23)</i>
Kriteri 5. Njësi përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	N/A
Kriteri 6. Programi i	N/A

studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).				
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Aktivitete kërkimore shkencore zhvillohen ndërsa DPET angazhohet për të lidhur dhe për t'iu përgjigur marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me aktorë të rinj të veprimtarisë shkencore. Departamenti mbështet realizimin e konferencave dhe aktiviteteve kërkimore ndërsa të diplomuarit janë konkurrues për tregun e brendshëm dhe të jashtëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	Institucioni ndjek një politikë të qartë si dhe harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.

seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Gjatë ciklit të dytë të studimeve, studenti duhet të thellojë njohuritë dhe aftësitë në fushën e studimit. Orët e mësimit i përshtaten natyrës së lëndëve me qëllim angazhimin e të gjithë studenteve në synimin e arritjes të një nxënie efikase. Për të pasur një përvetësim sa më të mirë të njohurive procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, praktikat profesionale, etj. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Plani mësimor është i organizuar sipas kategorive lëndore si më poshtë: 1. Lëndët në planin mësimor janë të klasifikuara sipas kategorive: 2. Lëndë Bazë (kategoria A), 12 kredite, 10%; 3. Lënda Karakterizuese (kategoria B), 48 kredite, 40%; 4. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (kategoria C), 30 kredite, 25%; 5. Lëndë Plotësuese (kategoria D), 12 kredite, 10%; 6. Detyrime Përmblylëse (kategoria E), 15 kredite, 15% Nga përlllogaritja e mësipërme, GVJ konstaton se, në planin mësimor të programit të studimi MP në Turizëm shpërndarja e krediteve sipas kategorive të lëndëve nuk është në përputhje me VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. Kategori Detyrime Përmblylëse zë 15% të totalit të orëve, që sipas përcaktimeve duhet të zërë 3-5%, ndërsa kategoritë A, B dhe C zënë një përqindje të ulët pa arritur në pragun minimal të përqindjeve të përcaktuara nga kjo VKM. <i>Mbështetur në këtë konstim GVJ rekomandon rishikimin e ngarkesës në kredite të çdo kategorie lëndore dhe respektimin e shpërndarjes së përqindjeve në përputhje me normat e përcaktuara në aktet ligjore të sipër cituara.</i> <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit Evidencë II.2 Plani mësimor Bachelor në Turizëm Evidencë. Tabelë Përmbledhëse, Tabela 9 Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i>
--	--

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Institucioni referon se, personeli akademik respekton diversitetin e nevojave të studentëve duke operuar me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies me qëllim gjithëpërfshirjen. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime që organizohen nga personeli akademik për të përvetësuar konceptet themelore të lëndëve si dhe për të konsultuar lidhur me temën e diplomës. Gjatë zhvillimit të lëndëve sipas planit mësimor, realizohen edhe leksione të hapura nga ekspertë të fushës së arsimit, mësim në laboratore, seanca diskutimesh. Gjatë periudhës së pandemisë, mësimi u zhvillua online përmes platformave Teams, Classroom, Edumeeet. Gjithashtu, mësimdhënia është përqendruar edhe në metoda didaktike innovative duke përdorur teknologji të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë III.5 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie</i> <i>Evidencë III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online</i> <i>Evidencë III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeeet</i> <i>Evidencë III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365</i> <i>Evidencë III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik</i> <i>Evidencë III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UGJ përmirëson në vijimësi aftësitë e personelit akademik për mësimdhënie, apo aftësitë didaktike përmes marrjes së eksperiencave si brenda vendit edhe jashtë vendit, këto të fundit përmes shkëmbimeve të trajnimit me universitete të huaja. Bashkëpunimet janë të mbështetura në marrëveshje të lidhura me UGJ dhe institucioneve të tjera arsimore publike dhe private. Gjithashtu, UGJ përmirëson në vijimësi aftësitë e personelit akademik për mësimdhënie nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës, modernizimit të laboratorëve si dhe hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme innovative në mësimdhënie.

	<i>Evidencë III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik</i> <i>Evidencë III.5 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie</i> <i>Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ</i> <i>Evidencë I.19 Lista e projekteve të UGJ</i> <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Instituciononi referon se, ka të përcaktuara kriteret e detajuara për rekrutimet e personelit të angazhuar në mësimdhënien akademike si atë me kohë të plotë, por dhe atë me kohë të pjesshme. Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie nëse është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit, në vizitën që u bë në Institucion pedagogët referuan që mundoheshin ta zhvillonin leksionin në mënyrë interaktive me diskutime me referime të ndryshme. Paralelisht, studentët vlerësojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorit që zhvillohet. Studentët raportuan se gjatë leksioneve ata marrin pjesë në mënyrë aktive ndërsa pedagogët i përfshin në diskutime për çështje të lëndës. <i>Evidencë III.3 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik</i> <i>Vizitat ne IAL:</i> <i>(Takim me stafin akademik)</i> <i>(Takim me studentët)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	UGJ organizon periodikisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e pedagogëve/programit të studimeve. Në bazë të këtij aktiviteti merren masa të cilat pasqyrohen në raportin vjetor. Sugjerimet e tyre merren parasysh për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përdorimit të metodave bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie. <i>Evidencë III.7 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që	Nga dokumentat dhe vizita në UGJ rezulton se janë ngritur të gjitha strukturat për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Kështu, është ngritur sektori i Standardeve të Cilësisë dhe

promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Kurrikulave si dhe Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me jashtë. Të dyja këto njësi bashkëpunojnë me Njësinë Kryesore dhe Njësinë Bazë me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie. <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ</i> <i>Evidencë I.19 Lista e projekteve të UGJ</i> <i>Evidencë III.5 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie</i> <i>Evidencë II.26 IMPACT ËEEK 2023, Gjirokastra, Albania</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni ndjek një politikë të qartë si dhe harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Studentët vlersojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorit që zhvillohet. Gjithashtu, GVJ konstaton se në planin mësimor nuk është kryer shpërndarja e sasisë së krediteve sipas përcaktimeve në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.</i> <i>Për këtë rekomandohet rishikim i ngarkesës në kredite për çdo kategori lëndore dhe respektimin e shpërndarjes së përqindjeve në përputhje me normat e përcaktuara në aktet ligjore të sipërcituara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra	Konstatohet se UGJ dhe Fakulteti i Ekonomisë kanë miratuar

e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH”, lidhur me mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më konkretisht, në rregulloren e programit të studimit, përkatësisht neni 10, 11, në rregulloren e Fakultetit, neni 32, 33, 34, 35, 38, në rregulloren e UGJ, neni 68, 81, 82, 83, në rregulloren e NJPET, neni 28, 29, 30, 31, 32. Gjithashtu me anë të syllabuseve të lëndëve, studentët informohen për mënyrën e vlerësimit të dijeve të tyre. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor Bachelor në Turizëm</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët, ata referuan se, në fillim të çdo semestri studentët njihen me syllabusin e lëndës, modulin në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format, informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Studentët po ashtu njihen me mënyrën e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Studentët po ashtu pohuan se gjatë fillimit të moduleve/lëndëve pedagogu respektiv i informon ata mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive. <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe	Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Vlerësimi i studentëve bëhet përmes 2 elementëve: vlerësimi i vazhduar i cili zë një vlerësim prej 20% nga totali dhe vlerësimi për provimin përfundimtar i cili zë një vlerësim prej 80% nga totali. Totali i

kompetencat e fituara.	pikëve të fituara nga studenti në të gjithë këta elementë, mundëson vlerësimin e studentit me notë për lëndën përkatëse. Studentët e marrin informacionin për detyrimet e tyre në lëndë përveç se nga rregulloret edhe nga lektori ditën e parë të mësimin në atë lëndë. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë III.12 Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posacme të testimit të njohurive gjatë vitit akademik dhe projektit përfundimtar.</i> <i>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen qartë në rregulloren e departamentit si dhe atë të programit të studimeve. Studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive ndërsa pedagogët përdorin mënyra të alternative të vlerësimit në bazë të përcaktimeve në syllabus.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara	Gjatë vizitës në Institucion dhe dokumentacionit shoqërues të RVB dokumentohet gjithashtu në rregulloren e UGJ-së, rregulloren e Fakultetit, rregulloren e programit të studimit, dhe në syllabuset e lëndëve mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga ana e studentëve të këtij programi studimi. Në syllabus përcaktohet se vlerësimi i lëndës bëhet duke

në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	grumbulluar pikët e pjesëmarrjes dhe aktivizimit në mësim gjatë vitit akademik dhe reflektohet nota finale në provimin përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit zë 20%, kurse provimi përfundimtar 80%. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë II.2 Plan i mësimor Bachelor në Turizëm</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë III.2.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të rritur transparencën dhe saktësinë në vlerësimin e studentëve UGJ përdor platformën Clean Score për korrigjimin e provimeve. Përgjigja e provimeve i vjen në kohë reale pedagogut, së bashku me analizë të rezultateve dhe kalueshmërisë. Kjo është mundësi e mirë për korrigjimin e provimeve që zhvillohen me alternativa, pasi siguron shpejtësi e saktësi në përgjigjet dhe vlerësimin e studentëve. <i>Evidencë III.8 Marrëveshje bashkëpunimi me AADF</i> <i>Evidencë III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021</i> <i>Evidencë III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021</i> <i>Evidencë III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Institucioni referon që, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin si dhe sipas rregullores së studimeve të UGJ, rregullores së Departamentit dhe rregullores së programit të studimeve. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Bazuar në dokumenta dhe vizitën në institucion, studentit i krijohet mundësi të ketë vlerësim të plotë përmes disa

profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	elementëve, jo vetëm me provim por edhe përmes detyrës apo projektit të kursit, punë laboratorike dhe provim të ndërmjetëm. Njohja e rezultateve paraprake të provimeve publikohen në sistemin ESSE3 (Pitagora) brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Studentit i jepet mundësia të rishikojë tezën dhe të diskutojë me pedagogun përgjegjës rezultatet e provimit të parë, me qëllim që të përmirësojë rezultatet në provimin përfundimtar. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Aktet rregullatore të universitetit si rregullorja e studimeve, rregullorja e universitetit, Kodi i Etikës dhe Syllabuset e lëndëve parashikojnë rregulla strikte në mënyrë që të evitohet plagjiatura apo kopjimi gjatë kryerjes së provimeve. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë III.10 Kodi i Etikës</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Institucioni referon se dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 6 (gjashtë) ditëve nga data e zhvillimit të provimit, brenda të cilave përfshihen edhe seancat përkatëse sqaruese dhe hedhja e tyre në sistem. Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin. Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjës të njësisë bazë për të rivlerësuar rezultatin, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi se provimi i lëndës kryhet me sekretim dhe ky proces kryhet me praninë e komisionit.

	<i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë III.10 Kodi i Etikës</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipas informimit që u është bërë studentëve për shpalljen. Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin. Ankesa bëhet me shkrim nga ana e studentit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njësië Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjës të njësisë bazë për të rivlerësuar rezultatit, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi se provimi i lëndës kryhet me sekretim dhe ky proces kryhet me praninë e komisionit. Në rast se vërehen praktika që bien ndesh me rregulloren, Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani kanë të drejtë ndryshimi komisioni. <i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nëpërmjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo provimi nga pedagogu.</i> <i>Në raste ankesash studentët kanë mundësi të kërkojnë rishikim dhe të marrin feedback ndërsa procedura e ankimimit është e</i>

	<i>mundshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Institucioni referon se ky program do ti mundësojë studentëve formimin e njohurive, do të zhvillojë aftësitë profesionale dhe do të synojë në kërkimin shkencor të studentëve. Gjithashtu ky program zhvillon aplikimin e njohurive praktike, aftësitë kërkimore shkencore; si edhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme tek të diplomuarit, me qëllim që ata të integrohen më së miri në tregun e punës. Misioni kryesor i këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve / profesionistëve me njohjen dhe kompetencat e nevojshme që të punojnë në fushën e turizmit. <i>Evidencë II.2 Plani mësimor</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit, ka si synim plotësimin e kërkesave të tregut në fushën e turizmit, garanton zhvillimin e aftësive të studentëve në disa disiplina të ndërlidhura me ato të teknologjisë së informacionit, shkencave humane dhe komunikimit. Kështu nëse i referohemi planit mësimor, gjenden të ndërthurura disiplina sipas kategorizimit A/B/C/D. Syllabuset e lëndëve, saktësojnë metodologjinë e mësimdhënies. <i>Evidencë Tabelat Përmbledhëse (Tab. 9)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë	Në përfundim të lëndës (në fund të semestrit) pedagogët e lëndës realizojnë përsëritje të lëndës, ushtrimeve, rasteve, për të shqyrtuar kompetencat e studentëve të marra gjatë zhvillimit të lëndës, por dhe për të orientuar studentët për provimin përfundimtar. Departamenti shpall edhe orët e konsultimeve për çdo pedagog, po kështu edhe pushimi disa ditë për çdo provim ndihmon studentët të përsërisin lëndën. Në fund të vitit lektorët

në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	orientojnë studentët për detyrimet përmbyllëse, si praktika mësimore dhe tema e diplomës. <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë III.1.11 Zhvillimi i konsultimeve"</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se, mësimdhënia kryhet mbi bazën e njohurive të marra, në mënyrë që të realizohet arritja e kompetencave. Këto njohuri referojnë se u jepen studenteve në auditor, laborator dhe praktikat profesionale. Kjo mënyrë didaktike i bën të mundur studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre. Praktikant gjithashtu mendojnë pedagogët rrisin njohuritë e studentëve. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në praktikat profesionale të studentëve. Studentët gjatë takimit konfirmon qasjen pozitive dhe klimën e përshtatshme nga pedagogët gjatë procesit mësimor. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me Institucione jashtë vendit për të mundësuar mobilitetet e studentëve. <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë II.27 Pjesëmarrje në Panairin Eork and Study 2022</i> <i>Evidencë II.27.1 Pjesëmarrje në Panairin Eork and Study 2023</i> <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve</i> <i>Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik me kohë të plotë apo me kontratë, përpos orëve të planifikuara të leksioneve e seminareve, realizon edhe orë të hapura dhe seminare mbi zhvillimet e reja të teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit. E veçanta e programit të studimit MP në Turizëm është se 90% e ngarkesë mësimore mbulohet nga vetë personeli akadeimi i DPET. Si personeli PAK është vetëm 1 i angazhuar.

	<i>Evidencë. Tabela Përmbledhëse, Tabela 6.1, 6.2</i> <i>Evidencë III.15 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore të UGJ 2019-2020</i> <i>Evidencë III.15.1 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore të UGJ 2022-2023</i> <i>Evidencë III.15.3 Plani i veprimtarisë së FE</i> <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kerkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UGJ në strategjinë e zhvillimit parashikon mbështetje financiare për projektet kerkimore jo vetëm për personelin akademik por edhe për studentët. <i>Evidencë I.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ-së, Kërkimi dhe Studimet Shkencore; c) Objektivat</i> Gjithashtu, studentët kanë mundësinë e aplikimit për pjesëmarrje në konkurse, aplikime për bursë studimit, shkolla verore/dimërore si dhe programe Erasmus+ falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që UGJ ka krijuar ndër vite. https://uogj.edu.al/njoftime-te-ndryshme/			
Konkluzione	GVJ kontaton se: UGJ ka struktura e mekanizma në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Leksione të hapura dhe workshope zhvillohen periodikisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Baza ligjore për saktësimin e detyrimeve përmbyllëse të studentit, pra zhvillimi i provimit përfundimtar dhe punimi i diplomës është: Sipas VKM 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 879,

realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	datë 18.12.2019, nenit 59, 60, 61, 62, 63 të rregullores së studimeve të UGJ (neni 61), të rregullores së Fakultetit (neni 39) të rregullores së programit të studimit (neni 11). Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë edhe notën mesatare e cila i jep të drejtë studentit për të përgatitur dhe mbrojtur temën e diplomës. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Evidentohe se UGJ njofton studentët përmes seancave orientuese në auditor nga pedagogët për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si gjatë vitit akademik edhe në fund të vitit për detyrimet e tyre përmbyllëse. Veçanërisht për këto procedura bëhet fjalë edhe veprohet në zbatim të rregullores së studimeve në UGJ dhe Manualit të punimit të diplomës. Departamenti kujdeset që studentët të pajisen dhe informohen me të gjitha detyrimet përmbyllëse. Dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e detyrimeve përmbyllesë prezantohen në rregulloren e programit të studimit. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë III.11 Manuali i punimit të diplomës</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Vlerësimi final i studentëve bëhet përmes administrimit të provimit final të diplomës, i cili bazohet në testimin e njohurive. Këtu përfshihen të gjitha lëndët/modulet në bazë të aftësive individuale të studentit. Për të fituar diplomën në "Master Profesional në Turizëm" studenti duhet të japë me sukses provimin përfundimtar, në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor. Mbrojta e temës së diplomës kryhet para një komisioni të posaçëm që ngrihet me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe me miratim të Dekanit të Fakultetit. Teza e provimit hartohet nga anëtarët e komisionit, firmoset nga Drejtuesi i Departamentit miratohet nga Dekani i Fakultetit <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë III.11 Manuali i punimit të diplomës</i>

	<i>Evidencë III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Departamenti në fillim të vitit të fundit akademik përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. Njësia bazë miraton temat e mundshme për t'u përzgjedhur nga studentët. Pedagogu udhëheqës orienton studentin për strukturën e punimit, për nxjerrjen e rezultateve, formulimin e konkluzioneve e sugjerimeve. Në fund bëhet miratimi dhe vlerësimi i punimit të diplomës së studentit nga ana e pedagogut, para se të dorëzohet tema në departament për evidentim, para mbrojtjes në komision. Caktohen komisionet e mbrojtjes së diplomave nga ana e njësisë bazë, të cilat miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve, neni 61</i> <i>Evidencë II.15.1 Miratimi i fushave të studimit</i> <i>Evidencë III.11 Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	UGJ asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve për kryerjen e matjeve, në mjediset e institucionit apo jashtë tij. Kjo u referua nga pedagogët por edhe studentët gjatë takimeve. UGJ krijon mundësi për studentët për përgatitjen e e detyrave të kursit gjatë vitit, por edhe për përgatitjen e punimit të diplomës, përmes laboratorëve që ka vënë në dispozicion si dhe përmes bibliotekës online. <i>Evidencë III.2 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET</i> <i>Evidencë III.9 Informacion për Bibliotekën U-Library, Fondi i Librit</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në rregulloret e institucionit, saktësohet se në përfundim të mbrojtjes së diplomës para komisionit studenti vlerësohet me note, Vlerësimi pasqyrohet në procesverbal i cili u konstatua nga vizita në institucion që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Vlerësimet përfundimtare të lëndës/modulit dokumentohen në procesverbalin e provimit dhe në Regjistrin e notave.

	<i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve, neni 62</i> <i>Evidencë III.11 Manuali i punimit të diplomës</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve në programin e studimit Master, studenti pajiset me Diplomën Master Profesional në Turizëm, si dhe suplementin e Diplomës. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë, shoqerohen me suplementin e diplomës. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve, neni 65</i> <i>Evidencë II.4 Model diplome</i> <i>Evidencë II.4.3 Model suplementi i diplomës</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UGJ e ka të detyrueshme të ruajë dhe të arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet informacione për studentët nëse kërkohet. <i>Evidencë I.1 Statuti i Universitetit</i> <i>Evidencë III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse. Studenti mund të ndërmarrë këtë hap vetëm në momentin që ka mbyllur të gjitha detyrimet akademike dhe këshillohet nga udhëheqësi akademik për mbylljen me sukses të temës së diplomës. UGJ pajis studentin me Diplomë dhe Suplement Diplome të miratuar nga QSHA.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni referon se Departamenti, bashkëpunon me aktorë të rëndësishëm në funksion të mësimdhënies për praktikën profesionale. Paralelisht, infrastruktura e UGJ është në funksion të studentëve. GVJ konfirmon se mjediset mësimore në DPET përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të lëndëve, aftësimit teorik dhe praktik, si dhe të objektivave formuese të programit të studimit MP në "Turizëm" Instrumentat teknik, teknologjike janë vënë në shërbim të përmbushjes së objektivave mësimore dhe specifikave të lëndëve në tri laboratorë të informatikës në sallat 401, 402, 403 dhe dy klasa digjitale në Godinën B respektivisht 301, 302. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me gjendjen fizike të paisjeve digjitale dhe mjediset laboratorike. <i>Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Institucioni referon se ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, të cilat u japin mundësinë studentëve të kryejnë praktikën mësimore pranë ambienteve të tyre. <i>Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale ka 12 kredite ECTS. Në përfundim të Praktikës Profesionale, studenti bën mbrojtjen e saj para një komisioni prej 2 anëtarësh nga personeli akademik duke paraqitur si pjesë të dosjes edhe vërtetimin e kryerjes së praktikës që lëshohet nga institucionit pritës. Praktika profesionale vlerësohet me notë. <i>Evidencë II.6 Rregullore e FE, neni 29</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: <i>Institucioni garanton mjedise të përshtatshme për realizimin e praktikës duke bashkëpunuar me Institucione të tjera ndërsa paralelisht përdor ambientet e veta për punë laboratorike.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit është përgjegjës për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore sipas nenit 25, të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 80/2015. Ai rekruton dhe angazhon në zhvillimin e programit të studimit personel akademik i cili përmbush kërkesat ligjore në fuqi, përsa i përket nivelit të kualifikimit akademik, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit, siç pasqyrohet edhe në tabelën përmbledhëse të mëposhtme.					
	Personeli i angazhuar në programin e studimit MP në Turizëm,	Viti akademik 2022-2023		Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE PAK

Prof Dr	1	-	1	-	1	-
Prof.Assoc	4	-	1	-	1	-
Dr/Doc	4	1	9	-	8	1
Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	-	-
Msc	1	-	-	-	-	-
Ne total	10	1	11	-	10	1

Nga të dhënat e mësipërme GVJ evidenton se, në programin e studimit angazhohen personel akademik me tituj akademik Prof. Dr dhe Prof. Assoc të cilët garantojnë ofrimin me cilësi të lëndëve dhe moduleve të programit dhe pjesmarrjen në kërkimin shkencor. Lidhur me personel ndihmës akademik në ka të dhëna për ekzistencën e tyre.

Evidencë: Anekset MP, Tabelat përmbledhëse (Tab. 6.1; 6.2; 6.3).

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar **ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 4, konstaton se personeli akademik efektiv i këtij program studimi, ka mbuluar ngarkesën mësimore të programit të studimit në raportet 95.3% PAE dhe 4.7% PAK për vitin akademik 2022-2023; 100% për vitin akademik 2021-2022; 95.3% PAE dhe 4.7% PAK për vitin akademik 2020-2021.

Bazuar në VKM Nr.418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre”, pika 2, gërma b, nënpika ii, i cili thekson se “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program mësimi”, GVJ vlerëson se personeli akademik efektiv për programin e studimit MP në “Bachelor” në Turizëm mbulon **95%** të ngarkesës mësimore.

GVJ vlerëson plotësimin e kriterit brenda standartit ligjor në angazhimin e personelit akademik efektiv në këtë program studimi gati në masë 100% duke grantuar qëndrueshmëri të

	<i>programit si një pikë e fortë e tij.</i> <i>RVB;</i> <i>Evidencë: Anekset MP, Tabelat përmbledhëse (Tab. 12.1; 12.2; 12.3).</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstatin se UGJ garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit MP në “Turizëm”, për të gjithë periudhën e akreditimit. Dokumentacioni bashkëshoqërues, vizita në institucion dhe takimi me drejtuesen e Zyrës së Burimeve njerëzore konfirmojnë këtë konstatim. <i>RVB;</i> <i>Evidencë: Anekset MP, Tabelat përmbledhëse (Tab. 12.1; 12.2; 12.3).</i> <i>Evidencë: IV.3 Listë pagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personelin akademik periudhën Janar-Maj 2023</i> <i>Evidencë: IV.3.1 Model kontratë punësimi</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konfirmon se UGJ harton dhe ndjek procedura për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik, në mbështetje të akteve ligjore. Procedurat e rekrutimit janë të mirëpërcaktuara nga DPET, duke filluar me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe ato specifike, përcjelljen e kërkesës për punësim dhe miratimin e saj nga Rektori dhe më tej kalohet në procesin e publikimit në Buletinën e Prokurimeve Publike dhe në faqen zyrtare online të universitetit. Komisionet “ad-hoc” të ngritura nga Rektori i UGJ ose Dekani i FE bëjnë vlerësimin e kandidaturave, ndërsa struktura menaxhuese e burimeve njerëzore mbështet procedurat e konkurimit në zhvillimin e tyre. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me raste të rekrutimit të personelit akademik të kategorive PAE dhe PAK. <i>Evidenca I.1 Statuti I univeristetit “Eqerem Çabej”, neni 56</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e univeristetit “Eqerem Çabej,</i>

	<i>Evidenca II.12 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrative nenet 3, 5, 8, 9.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstaton se 1 (një) personel ndihmës akademik është pjesë e DPET, i cili është i angazhuar në ndihmë të realizimit të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjes së tyre dhe mjediseve të tjera mësimore. Institucioni ka të përcaktuar në rregullore mënyrën e rekrutimit të stafit ndihmës akademik, detyrimet dhe përgjegjësitë e punës së tij, të dëshmuara në evidencat në vijim. UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në ndihme të realizimit të orëve praktike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore. <i>Evidenca II.12 Organograma e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë: Anekset MP, Tabelat përmbledhëse (Tab. 2)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UGJ mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit MP në "Turizëm", në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky proces kryhet nga Sektori i Shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative (DSHNA) i cili kryen veprimtarinë e tij në bazë të statutit të UGJ dhe rregullores përkatëse. Gjithashtu të dhëna për veprimtarinë shkencore dhe angazhimet profesionale të personelit akademik ruhen dhe administrohen dhe nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Veprimtaria e këtij sektori bazohet në Rregulloren e DSHNA-A Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se DPET ruan të dhëna mbi angazhimin e kohës vjetore dhe për çdo semestër të punës së personelit akademik dhe ndihmës akademik. <i>Evidenca I.1 Statuti i universitetit "Eqerem Çabej",</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca IV. 1 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale</i> <i>Evidenca IV.4 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA nenet 4 dhe 5.</i> <i>Vizita në institucion.</i>

Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Universiteti “Eqrem Cabej” dëshmon se ka marrëveshje bashkëpunimi, me insitucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe institucione të tjera lokale dhe agjenci kombëtare, të cilat i vë në funksion të programit mësimor. Universiteti qysh nga viti 1993 ka nënshkruar 126 marrëveshje bashkëpunimi duke filluar nga kohëzgjatje të pacaktuar deri në ato me kohëzgjatje 6 vjecare. Këto bashkëpunime i vijnë në ndihmë departamentit për realizimet e diplomave të studentëve si të programit të studimit ashtu dhe veprimtarive të tjera duke përjashtuar udhëheqjen e studentëve në praktikën profesionale. Gjithashtu DPET, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. Bazuar në dokumentacionin bashkëshoqërues dhe takimit në institucion (me personelin akademik dhe studentet), GVJ konstaton se studentët realizojnë punimin e diplomës pasi drafti i saj kalon në procedura miratimi, ndërsa udhëheqësit shkencore udhëheqin dhe monitorojnë realizimin e saj. Bashkepunimi me insitucione të tjera shihet si frutdhënes nga studentët dhe si ndikues në rritjen e aftësive profesionale dhe akademike.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<i>Vizita në institucion,</i> <i>Evidenca II.15.1 Lista me fushat e përgjithëshme për emërtimin e temave për mbrojtjen e diplomës</i> <i>Evidenca III. 10 Manuali i punimit të diplomës, Shtojca e rregullores së studimeve</i> Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët konfirmoi se personeli mbikqyrës që anagzhohet në realizimin e praktikave profesionale ndihmojnë student në përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse dhe kryejnë edhe vlerësimin e praktikës profesionale. <i>RVB</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se, personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të</i>

	<i>studimit.</i> <i>Gjithashtu GVJ vlerëson plotësimin e kriterit 2 (dy) brenda standartit ligjor në angazhimin e personelit akademik efektiv në këtë program studimi gati në në masëm 100% duke grantuar qëndrueshmëri të programit si një pikë e fortë e tij. Standarti përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Dokumentacioni bashkëshoqërues dhe vizita në institucion konfirmojnë se Universiteti “Eqrem Cabej”, siguron kushte të përshtatshme fizike për zhvillimin e veprimtarisë mësimore (si ato higjeno-sannitare, të potencializimit të ndricimit, mbrojtjes ndaj zjarrit, ngrohjes dhe ftohjes, lagështirës). DPET e zhvillon procesin mësimor në Godinën A e cila ka një sipërfaqe prej 1937 m². Kjo godinë ka kapacitet për 951 vende për zhvillimin e lekioneve dhe seminareve. Ndërsa raporti i MAS mbi “Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024”, tregon se Uiversiteti “Eqrem Cabej” ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 m²/student. Në ndihmë të zhvillimit të veprimtarisë mësimore si për leksionet dhe seminarat e programit të studimit, shërbejnë dhe mjediset e bibliotekës dhe dy labororet e informatikës të cilat gjenden po në Godinën B. <i>Evidenca II.18.3 Raport i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca IV.7 Infrastruktura e UGJ</i> <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE – Mjediset e Fakultetit/njësive Bazë Tabela 16</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të	Institucioni ka pajisur mjediset mësimore me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, me qëllim që studentët dhe personeli akademik të maksimalizojnë përdorimin e tyre në

pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	funksion të zhvillimit cilësor të procesit mësimor të mësimdhënies dhe nxënies. Gjatë vizitës në institucion, në Godinën B, ku zhvillojnë procesin mësimor në laboratorë studentët e programit të studimit MP në "Turizëm", GVJ konstatoi se infrastruktura laboratorike (pajisje të laboratorit të arkeologjisë dhe gjeografisë, GIS dhe hartat e ndryshme), didaktike ishin të pranishme dhe të aksesueshme në cdo moment të nevojshëm si për studentet ashtu dhe për personelin akademik, në ndihmë të përgatitjes dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik. GVJ kishte mundësinë t'i vëzhgonte konkretisht. Mjediset e institucionit, mjetet informatike e teknike aksesohen në kushte të barabarta për të gjithë studentët, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga procesi mësimor. <i>Evidenca III.2 Inventari I mjeteve didaktike dhe teknologjike në NJBPET</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ konfirmon se mjediset mësimore në DPET përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të lëndëve, aftësimin teorik dhe praktik, si dhe të objektivave formuese të programit të studimit MP në "Turizëm" Instrumentat teknik, teknologjike janë vënë në shërbim të përmbushjes së objektivave mësimore dhe specifikave të lëndëve në tri laboratorë të informatikës në sallat 401, 402, 403 dhe dy klasa digjitale në Godinën B respektivisht 301, 302. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me gjendjen fizike të paisjeve digjitale dhe mjediset laboratorike. <i>RVB</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike dhe teknologjike në NJBPET</i> <i>Evidenca IV.7 Infrastruktura e UGJ</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe	UGJ vënë në shërbim të përmbushjes së objektivave mësimore dhe specifikave të lëndëve në tri laboratorë të informatikës në sallat 401, 402, 403 dhe dy klasa digjitale në Godinën B respektivisht 301, 302. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh konkretisht me gjendjen fizike të paisjeve digjitale dhe mjediset

profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	laboratorike. Këto laboratorë shërbejnë edhe për studentët e programit të studimit MP në Turizëm. Kjo konfirmohet edhe nga studenyt e këtij programi gjatë takimit me ta në institucion. <i>Vizita në institucion</i> <i>Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike dhe teknologjike në NJBPET</i> <i>Evidenca IV.7 Infrastruktura e UGJ</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	UGJ me kapacitete infrastrukturore që ka garanton zhvillimin e praktikave profesionale apo veprimtari të tjera praktike si trajnime, workshope dhe praktika për studentët e MP “Turizëm” me ose institucione të tjera bashkëpunore në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ato kanë nënshkruar. <i>RVB</i> <i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjësen e njësisë bazë dhe personelin akademik</i>			
Konkluzione	<i>GVJ nëpërmjet dokumentacioni bashkëshoqërues, evidentimeve gjatë vizitës në institucion konstaton përmbushjen plotësisht të standartit. Mjediset mësimore, laboratorët lëndorë dhe teknologjik etj, mundësojnë realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit MP në “Turizëm” dhe procesit të nxënies praktike. Standarti përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, në takimet me personelin akademik dhe studentët, u konstatua një marrëdhënie bashkëpunuese pozitive në drejtim të garantimit të marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme nëpërmjet literaturës bazë (në gjuhën shqipe) dhe ndihmëse (në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja). Ajo ofrohet në formë fizike dhe/ose online. Një rol mbështetës në këtë drejtim luan biblioteka e universitetit me dhe fondet e tyre fizike dhe digjitale. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse është e evidente në syllabuset e lëndëve dhe përcaktimi i tyre kalon në procedurë miratimi nga ana e DPET, dëshmuar në dokumentacionin institucional. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion, takim me punonjësit e bibliotekës</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar konstatohet se, DPET, FE përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqesin propozimet për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. <i>Evidenca IV.8 Raportime nga biblioteka për departamentin</i> <i>Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën në U-library, Fondi I librit</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GJU vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik mjediset e bibliotekës e cila ndodhet në Godinën C të UGJ. Sallat e saj janë të pajisura me infrastrukturë mbështetëse dhe lehtësuese për studentët. Studentët mund të shfrytëzojnë në mënyrë të barabartë bibliotekën mësimore, pasi janë regjistruar dhe janë pajisur me një kartelë personale. Ata mund të shfrytëzojnë dhe bibliotekën online. Fondi i librave paraqitet i përshtatshëm në fushën e programit të studimit MP në “Turizëm” Biblioteka shërben edhe si sallë interneti.

	Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë ti verifikoj edhe në gjendje fizike. <i>Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën në U-library, Fondi I librit</i> <i>Evidenca IV.9 Biblioteka Kartelë personale e përdoruesit</i> <i>Vizita në institucion, takimi në bibliotekë</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues (evidenca III.8) jepen të dhëna për fondin total të UGJ në gjuhën shqipe dhe atë të huaj, blerjet e reja, dhurimet nga AKSHSH dhe individë. Në përmbajtjen e furnizimeve me libra për periudhën 2021-2023 titujt e librave janë të gjithë në gjuhën shqipe në lëmin e letërisë dhe historisë, të vetmit tituj që lidhen me fushën e turizmit ishin “Ekonomia e Turizmit” dhe “Turizmi” të cilat zënë një vend të pa përfillshëm në investim. Po nga (evidenca III.8) nuk mund të marrësh informacion sesa është fondi i librave të blerë për periudhën 2021-2023 për DPET sepse ka informacion vetëm për FESHSH. Për të plotësuar mangësitë e konstatuara në dokumentacion GVJ gjatë vizitës në bibliotekë kërkoi të njihet me fondin që përfshin tekstet mësimore bazë, literaturën ndihmëse apo revistat shkencore. Gjatë verifikimit konstatoi se tekstet mësimore gjendeshin në fond dhe në shumicën dërmuese ishin në gjuhën shqipe. Ato ishin të mjaftueshme për mbulimin e lëndëve dhe moduleve lëndore. <u>GVJ sygjeron</u> rritjen e investimeve në fondin e teksteve dhe literaturës në fushën e turizmit, veçanërisht në gjuhë të huaj. <i>Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën në U-library, Fondi I librit</i> <i>Vizita në institucion, takimi në bibliotekë</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstaton se funksionimi i bibliotekës kundrejt shërbimeve ndaj studentëve dhe personelit akademik realizohet në kushte të barabarta dhe ajo ofron shërbimin e saj pa pagesë. Studentët dhe personeli akademik kanë aksesin e tyre në shërbimin <i>on-line</i> të Bibliotekës “U-Library”, [https://ulibrary.rash.al/], [https://uogj.edu.al/biblioteka-online/] dhe JSTOR. U evidentua se abonimi i Bibliotekës në revista shkencore ndërkombëtare <i>on-</i>

	<i>line, ka krijuar mundësi për studentët/pedagogët në qasjet ndërkombëtare akademike, duke mundësuar shfrytëzimin e literaturës në gjuhë të huaj.</i> <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE- Tabela 17</i> <i>Evidenca IV.9.1 Biblioteka, Manuali i përdorimit</i> <i>Vizita në institucion, takimi në bibliotekë</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ evidenton se biblioteka u ka mundësuar studentëve dhe personelit akademik që nëpërmjet programeve kompjuterike të bëjnë të mundur aksesimin dhe shfrytëzimin e fondit të bibliotekës, përmendim këtu programin COBISS (aksesim në 1900 tituj), aksesimin elektronik në U-Library, JSTOR dhe International Association Universities. Ajo ka 3 salla dhe 53 vende studimi. <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Mjediset e bibliotekës qëndrojnë të hapura gjatë ditëve të javës (nga e hënë në të premte), në orarin 8:00-19:00, duke u krijuar mundësi studentëve dhe personelit akademik aksesimin e literaturës së nevojshme, në varësi të zhvillimit të procesit mësimor, por dhe në përgjigje të nevojave të lexuesve. GVJ konstatoi afishimin e orarit në mjediset e institucionit duke bërë të mundur orientimin e lexuesve të saj mbi aksesimin dhe mundësitë e hyrjes në Bibliotekë. <i>RVB</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit,	GVJ evidenton se njësia bazë e programit të studimit MP në “Turizëm” dhe biblioteka ndjekin dhe raportojnë mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit <i>on-line</i>, përditësimin; shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit <i>on-line</i>. <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 17</i> pasqyrojnë gjendjen mbi fondin e bibliotekës dhe të dhënat e plota mbi platformat <i>on-line</i>/strukturat e teknologjisë së infomacionit për bibliotekat. Fondi i titujve pasurohet herepashere nëpërmjet dy formave: nga blerjet/abonimet dhe dhurimet. Ato i kanë shërbyer dhe personelit akademik në veprimtaritë e tyre akademike dhe kualifikimet profesionale.

shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Vizita në institucion, takimi në bibliotekë			
Konkluzione	UGJ mbështet veprimtarinë mësimore të programit të studimit MP në "Turizëm" me infrastrukturën fizike të nevojshme, mjediset e bibliotekës, aksesimin e fondit të saj fizik dhe online. Ai duhet të bëjë më shuëm përpjekje për pasurimin e literaturës në turizëm me synim rritjen e performancës së personelit akademik dhe mbështetjes së mësimdhënies dhe nxënies. GVJ sygjeron rritjen e investimeve në fondin e teksteve dhe literaturës në fushën e turizmit, veçanërisht në gjuhë të huaj. Standarti përmbushet kryesisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur, GVJ evidenton se UGJ disponon sistem të menaxhimit, të organizuar në disa pjesë, nëpërmjet të cilit administron të gjitha informacionet që lidhen me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky menaxhim nis qysh me systemin U-Albania e cila është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSHA. Ndërsa sistemi elektronik Pitagora është një sistemi tjetër në funksion të studentëve, pedagogëve, sekretarisë, administratorëve, si dhe më herët ka funksionuar sistemi elektronik i automatizimit të proceseve të Sekretarisë Mësimore dhe shërbimeve on-line për studentët, Sistemi Esse3.

	<i>Evidenca IV.10 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3.pdf</i> <i>Evidenca V.5 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf</i> <i>Evidenca III.12 Rregullore e Sekretarise mesimore.pdf</i> <i>https://uogj.pitagora.rash.al/login</i> <i>http://uogj.edu.al/upload/Posterat_PEDAGOGU_pitagora.pdf</i> <i>http://uogj.edu.al/upload/Posterat_STUDENTI_pitagora.pdf</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstaton se DPET ruan dhe menaxhon dokumentacionin mbi aktivitetin kërkimor-shkencor, dhe të procesit mësimor të njësisë së programit të studimit MP në “Turizëm”, ndërkohë bashkë me UGJ menaxhojnë dokumentacioni e personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. UGJ e menaxhon informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin nëpërmjet dy sektorëve: 1) Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative, Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sektorit Protokoll. 2) Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve më Jashtë, i cili administron bazën e të dhënave të kërkimit shkencor, të personelit akademik. <i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ.</i> <i>Evidenca IV.9 Rregullore e DSHNA</i> <i>Evidenca IV.9 Rregullore e DSHNA</i> <i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ</i> <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 4,</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>RVB</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Ky kriter plotësohet pasi UGJ nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora u siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente, të gjithë personelit dhe studentëve të programit të studimit MP në “Turizëm”. Personeli akademik, studentët dhe ai ndihmës akademik aksesojnë informacionin si individual ashtu dhe për lëndët mësimore, orarin, vlerësimet, njoftimet e ndryshme etj. Stafi ndihmës akademik dhe ai administrativ mbështet me këtë menaxhim, duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e gjithësecilit. Një mënyre e dytë e aksesimit të informacionit të përditësuar mbi veprimtarinë e DPET dhe gjithë universitetit është dhe faqja zyrtare online e UGJ.

	<i>Evidenca IV.30. Marrëveshje bashkëpunimi UGJ-RASH</i> <i>Evidenca III.30. Platforma softëare Pitagora</i> <i>Evidenca III.31. Regjistrimi i Pedagogëve në Pitagora</i> <i>Evidenca III.32. Regjistrimi i Studentëve në Pitagora</i> https://uogj.pitagora.rash.al/login http://uogj.edu.al/upload/Posterat_Pedagogu_pitagora.pdf http://uogj.edu.al/upload/Posterat_Studenti_pitagora.pdf <i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	UGJ ka zgjedhur të përdorë paketën e platformës Microsoft Office 365, Microsoft Teams për të mundësuar komunikimin interaktiv midis personelit akademik dhe studentëve. Ata shkëmbejnë informacione të nevojshme në kohë reale në dobi të procesit mësimor dhe edukativ. Për aksesimin e platformës janë hartuar manualët e përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për personelin akademik dhe studentët. <i>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik.</i> <i>Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët</i> <i>Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365.pdf</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Fakti që platformat e përzgjedhura (evidentuar më sipër) për përdorim nga UGJ mund të aksesohen në kohë reale, krijojnë mundësi që palët vepruese të gjenerojnë të dhëna evidente dhe të monitorueshme në çdo kohë. Organet drejtuese lehtësisht mundësojnë raportime mbi aktivitetin akademik, administrative dhe ecurinë e procesit mësimor, përfshirë dhe veprimtaritë akademike dhe menaxhuese të vlerësimit të studentëve. Në linkun në vijim studentët mund të monitorojnë nevojat e tyre nëpërmjet faqes online të UGJ në zërin: “Hapësira Online për Studentët Pitagora”, Hapesira Online për Studentet Pitagora (uogj.edu.al) <i>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik.pdf</i> <i>Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online</i>

	<i>Office 365.pdf</i> <i>Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeet.pdf</i> <i>Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom.pdf</i> <i>Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet.pdf</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ hulumtoi faqen zyrtare online të UGJ dhe konfirmon se informacioni mundësohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën e huaj angleze. Po kështu informacion në të dy gjuhët, shfaqen dhe për DPETA publikuar në faqen zyrtare online të UGJ. http://uogj.edu.al/			
Konkluzione	UGJ ka disa platforma elektronike si psh: U-Albania, Pitagora, Microsoft Teams, dhe kanalin komunikues të faqes zyrtare web të UGJ të cilat bëjnë të mundur informimin, administrimin, monitorimin e veprimtarisë mësimore, praktikave administrative, financiare, shkencore në dobi të programit të studimit. Dokumentacionet bashkëshoqëruese mbështesin këtë konstatim. GVJ konstaton përmbushjen plotësisht të standardit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se UGJ harton raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare, përfshirë në të dhe programin e studimit Master Profesional "Turizëm". Vihet re një bashkëveprim midis hallkave të institucionit me qëllim vlerësimin, realizimin e maksimalizimin e përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të DPET. Hartimi i raportit financiar bazohet në Statutin e UGJ. Raportet janë vjetore dhe parashtrojnë të dhënat financiare në vazhdimësi.

	<i>Evidenca I.1 Statuti UGJ</i> <i>Evidenca IV.11 Propozim Buxheti NJBPET</i> <i>Evidenca II.5 Prpozim buxheti njësia kryesore</i> <i>Evidenca IV.II.4 Projekt buxheti i vitit 2023 projekt buxheti aftamesëm 2023-2025</i> <i>Evidenca I.3. Startegjia e Zhvillimit të FE-së Kreu Financat dhe Burimet financiare</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Neni 99 i statutit të UGJ, përcakton qartësisht burimet e financimit të UGJ (buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimin; të ardhurat e krijuara nga të mësuarit gjatë gjithë jetës; të ardhurat nga shërbimet e kryera për subjekte publike dhe private, vendase dhe të huaja, si dhe ndaj studentëve; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të treta; donacione, dhurata, trashëgimitë; të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kërkimore-shkencore; të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e mjediseve të cilat janë në administrim të UGJ-së, për palët e treta, në formën e kontratave të qiradhënies apo me forma të tjera kontraktimi, burime të tjera të ligjshme financimi). Njësia bazë financohet sipas planit të financimit institucional bazuar dhe në pikat 2 dhe 3 të nenit 99 të statutit të UGJ. Menaxhimi i planit të miratuar, kryhet nga Drejtoria e Shërbimeve Universitare, në varësi të kërkesave dhe nevojave të njësive. <i>Evidenca IV.11.1 Raporti vjetor finnciar 2020</i> <i>Evidenca IV.11.2 Raporti vjetor finnciar 2021</i> <i>Evidenca IV.11.3 Raporti vjetor finnciar 2022</i> <i>Evidenca IV.20, ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 18</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Ndjekja e zbatueshmërisë së planit të financimit institucional dhe raportimet periodike financiare bëjnë të mundur vlerësimin e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raportet financiare përmban detajime financiare si ato të financimit të burimeve njerëzore, si dhe të shpenzimeve të tjera sipas kategorive specifike. Gjithashtu në mënyrë periodike UGJ, si çdo institucion publik, i nënshtrohet auditit financiar prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MAS.

	<i>Evidenca IV.11.1 Raporti vjetor finnciar 2020</i> <i>Evidenca IV.11.2 Raporti vjetor finnciar 2021</i> <i>Evidenca IV.11.3 Raporti vjetor finnciar 2022</i> <i>Evidenca IV.12.2 Rapor i MASR AUDIT 2022</i> ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 18 RVB
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se institucioni vlerëson dhe dokumenton gjëndjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Gjithashtu DPET dhe anëtarët e tij janë vënë në dijeni mbi financimet dhe mundësitë e përmbushjes së nevojave financiare të departamentit. Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe administratori i UGJ raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës edhe në Senatin Akademik të UGJ dhe Bordin e Administrimit. <i>Vizita në institucion, takimet me personelin akademik</i> <i>Evidenca IV.11.1 Raporti vjetor finnciar 2020</i> <i>Evidenca IV.11.2 Raporti vjetor finnciar 2021</i> <i>Evidenca IV.11.3 Raporti vjetor finnciar 2022</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Qëndrueshmëria financiare për zhvillimin e programeve të studimit të DPET dhe departamenteve të tjera të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, realizohet në bazë të analizës financiare të financimeve dhe shpenzimeve të nevojshme në kontekstin e profilit të vet universitetit. Kjo qëndrueshmëri bazohet në financimet që akordon buxheti i shtetit dhe financimet nga të ardhurat dytësore si tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni. <i>Takimi në institucion konfirmoi këtë konstatim si dhe evidentoi gatishmërinë në ndërhyrjet të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</i> RVB ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 18
Konkluzione	<i>UGJ garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ eidenton se ky standart përmbushet plotësisht.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Vizita në institucion, takimet me personelin akademik dhe autoritetet drejtuese, studentët si dhe vlerësimi i dokumentave bashkëshoqërues konstatojnë se UGJ harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe akteve rregullatore. <i>RVB</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e univeritetit "Eqrem Çabej,</i> <i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC, SSCK</i> <i>Evidenca V.6 Rregullore për funksionimin e DSHNA</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe	GVJ konstaton se Universiteti "Eqrem Çabej" ka mirëpasqyruar në dokumentacionin ligjor bashkëshoqërues, si: statuti i UGJ, kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë studimeve universitare. Dokumenta të tjerë rregullues janë Rregullorja e

studentët e programit të studimit.	UGJ, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e DPET të cilat rregullojnë praktikën informuese, politikat dhe procedurat e nevojshme, transparente dhe të barabarta për studentët kandidatë dhe ata të programit MP në "Turizëm". Hulumtimi në faqen online të UGJ, tregon transparencën mbi kuotat e pranimit në këtë institucion, si dhe evidentimin e kësaj faqeje një një burim i rendësishëm i informacionit për politikat dhe procedurat nga hyrja deri në dalje për studentët dhe më gjerë. <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e univeritetit "Eqerem Çabej,</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i> https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit shoqërues konfirmon se UGJ harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Propozimet nga Njësitë bazë, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati Akademik. <u>Kriteret dhe Kuotat e Pranimit (uogj.edu.al)</u>. UGJ në programin MP në "Turizëm" parashikon regjistrimin e 2 (dy) kuotave të studentëve që aplikojnë për program të dytë studimi, 5 (pesë) kuota për student që duan të transferojnë prgramin e studimit dhe 1(një) kuotë për student me statusin e jetimit. <i>Institucioni nuk parashikon regjistrim për studentë të huaj dhe trojet në këtë program studimi.</i> <i>Evidenca II.17.1 Kuotat e propozuara 2021-2022</i> <i>Evidenca II.16.1 Kuotat e propozuara 2020-2021</i> <i>Evidenca II.19, Baza ligjore për aplikimet dhe regjistrimet në IAL VKM Nr. 436 "Për kriterin e mesatares", VKM Nr. 46 "Për kriterin e mesatares së përditësuar"</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose	Përmbushjen e këtij kriteri, institucioni e bazon në aktet ligjore dhe ato rregulluese (Rregullore e UGJ, Rregullore e studimeve të UGJ, Rregullore e FE, Rregullore e DPET), të cilat kanë evidentuar përcaktimin e kriterëve, procedurave të pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, ecurisë mësimore gjatë vitit akademik, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose

të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto akte ligjore dhe rregulluese janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku me disa mekanizma. Kriteret dhe informacionet për to janë lehtësisht të evidentueshëm në faqen online të UGJ. Afishimet në faqen online të UGJ dhe stendat e njoftimeve, veprimtaria e Sekretarisë Mësimore FE, dhe sistemi i Sekretarisë Mësimore Pitagora janë mbështetës në këto procese. Ndërkohë QSHA dhe RASH ndërveprojnë në këtë proces me UGJ. <i>Vizita në institucion</i> <i>RVB</i> https://uogj.pitagora.rash.al/ëëë.uogj.edu.al
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konfirmon se UGJ informon përpara fillimit të çdo viti akademik, publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet disa mënyrave si: publikimit në faqen online të informacioneve të nevojshme dhe në rrjetet sociale, zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, organizimit të takimeve promovuese, me nxënës maturan të shkollave të mesme; fletëpalosjeve dhe posteratve; Panairit work and study, etj. <i>Evidenca II.17.1 Vendimet e Senatit Akademik për kriteret për vitin akademik 2022-2023, kriteret e pranimit për vitin 2023-2024</i> <i>Evidenca II.18 Vendimet e Senatit Akademik për kriteret e pranimit 2023-2024, kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025</i> <i>RVB</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UGJ nuk parashikon kuota për kandidatë me aftësi të veçanta, (bazuar në vendimet mbi miratimin e kriterëve dhe kuotave). <i>Evidenca II.18.1 Kuotat e propozuara 2023-2024</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	UGJ parashikon kuota për kandidatë nga Republika e Kosovës, nga trojet shqipfolëse të shteteve të tjera si Maqedoni e Veriut,

akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Malë I Zi konkretisht nga 1 kuota për secilën (bazuar në vendimet mbi miratimin e kriterëve dhe kuotave), por nuk specifikohen kriteret specifike për përzgjedhjen e tyre, pasi pas aplikimit të tyre pranë IAL-ve, vendimarrjen e kryejnë përsëri IAL-t, për programin e studimit MP në "Turizëm". <i>Evidenca II.17.1 Kuotat e propozuara 2021-2022</i> RVB			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin dhe për programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konfirmon se UGJ ndërmerr, harton dhe zbaton politika të ndihmës dhe dhënies së bursave për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë. Mbështetjet dhe dhëniet e ndihmës janë kryesisht në bursa. <i>Evidenca II.7 Vendime Bordi i Administrimit për bursa dhe mbështetje për kategori të veçanta</i> RVB			
Konkluzione	UGJ harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve në programin e studimit. Dokumentacionet bashkësoqeruese sqarojnë politikat, procedurat, mbështetjet ligjore, format e informimit dhe të mbështetjes financiare, si dhe mundësitë e përfshirjes në studime të kategorive në nevojë dhe të studentëve nga trojet shqiptare. GVJ sygjeron përcaktimin e kriterëve specifike përzgjedhëse për kategorinë e studentëve me aftësi të veçanta apo ata nga trojet shqiptare. Përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në	UGJ nëpërmjet rregulloreve institucionale (të UGJ, FE, DPET, të programit të studimit) informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët, që në vitin e parë të studimeve, në lidhje

lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Gjithashtu në çdo fillim viti dhe në çdo semestër informohen për procesin mësimor të shtrirë gjatë vitit akademik, njihen me planin mesimor, orarin mësimor, ndërsa personeli akademik u jep informacion të detajuar për syllabuset, sesi realizohet ecuria e përparimit akademik, detyrimet lëndore, frekuentimin, format e kontrollit të dijeve të fituara, vlerësimine lëndore format e ankimimit. Dokumentacioni për këtë kriter paraqitet i bollshëm. <i>GVJ gjatë vizitës në institucion vuri re se informacione të rëndësishme u viheshin në dispozicion dhe në stendat e njoftimeve.</i> <i>RVB</i> www.uogj.edu.al <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e univeristetit "Eqerem Çabej,</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UGJ i ka të përcaktuara kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Këto janë parashtruar në rregulloret e njësisë kryesore deri tek ajo e njësisë bazë apo të programit. Studentët njihen në fillim të vitit mbi mundësitë e njohjes së krediteve në kuadër të programeve të shkëmbimit (mobiliteteve, Erasmus+), të cilat realizohen nga DPET-A. Sekretaritet mësimor dhe Komisioni i njohjes dhe i ekuivalentimit të lëndëve mësimore, informojnë dhe realizojnë procedurat e njohjes dhe ekuivalentimeve të lëndëve mësimore dhe krediteve përkatëse. <i>GVJ e konfirmoi këtë edhe gjatë vizitës në institucion, takimi me studentët.</i> <i>RVB</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	GVJ konfirmon se institucioni mbështetur në Rregulloret institucionale dhe DPET-A informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre,

vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	në programin e studimit. Kështu studentet informohen me format e vlerësimit të përparimit të tyre. <i>RVB</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit janë përcaktuar në rregulloret e: UGJ, të studimeve në UGJ, të FE, të programit të studimit MP “Turizëm”. Ciklin e parë të studimit, studentët e përmbyllur duke u diplomuar me provim përfundimtar formimi ose punim diplome. Ky prag ndarës i referohet mesatares së ponderuar të dy viteve të para të studimit, i cili për studentin që do të realizoj punim diplome, duhet të jete më i lartë se 8. (Rregullore e studimeve. Neni 59, Kreu VIII “Diplomimi”). DPET ka procedura të qarta për mënyrën e asistimit të studentëve, duke filluar më miratimin e fushave të studimit për punimin e diplomës, takime informues mbi procedurat e diplomimit në fillim të vitit të fundit. Ndërsa udhëheqësit shkencorë, të cilët janë personeli akademik i programit të studimit, udhëzojnë dhe qëndrojnë pranë akademikut studentit, për finalizimin me suksese të studimit dhe diplomimit në tërësi. E njëjta ndihmesë konsistente u sigurohet dhe studentëve që i përmbyllin studimet e tyre me provim të përgjithshëm përfundimtar. <i>RVB</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e univeristetit “Eqerem Çabej,</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Vizita në institucion,</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të	Bazuar në dokumentacionin shoqërues dhe takimet në institucion me personelin akademik, studentët dhe GVB u konfirmua se UGJ përdor forma të ndryshme të informimit të të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm. Ndër to përmenden: spotet informuese televizive, shpërndarja e informacionit nëpërmjet fletpalosjeve dhe posterave, pjesmarrjet e UGJ në serinë e panairëve “Work & Study”. Ndërsa zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit mbështet informimin e të interesuarve dhe

ardhshëm mbi programin e studimit.	studentëve të ardhshëm në mënyrë të vazhdueshme.			
	RVB <i>Vizita në institucion,</i>			
Konkluzione	<i>UGJ vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit MP në "Turizëm", informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit. GVJ shprehet për përmbushjen plotësisht të standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatje e programit të studimit MP në "Turizëm". Studentët njihen me rregulloret që funksionojnë në institucion dhe mundësitë e marrjes së informacionit nga to. Gjithashtu studentët informohen në mënyrë të hollësishme në takimet e fillim vitit akademik, gjatë të cilëve u jepet informacion i plotë rreth procesit mësimor, strukturës mësimore të vitit akademik, kohëzgjatjes së vitit akademik, sezoneve të provimeve, planit mësimor dhe lëndëve mësimore përkatëse, laboratorëve, bibliotekave dhe mundëive të aksesimit të informacionit. etj. RVB <i>Vizita në institucion, takimi me studentët, takimi me personelin akademik,</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e univeritetit "Eqerem Çabej,</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>ëëë.uogj.edu.al</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe	Bazuar në dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se UGJ dhe nënnjësitë e tij, vënë në dispozicion të studentëve dokumentacion institucionale, nëpërmjet të cilave ata njihen dhe

dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	informohen për lëndët, modulet, përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese. Rregulloret institucionale dhe programet lëndore (Syllabuset) janë dokumentat kryesore ku studentët njihen gjerësisht. <i>GVJ e konfirmon këtë edhe gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët.</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm</i> <i>Evidenca II.2 Plan Mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022</i> <i>Evidenca II.5 Programet Lëndore (Syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në Turizëm</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UGJ nëpërmjet Zyrës së Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar informon, mbështet institucionalisht dhe orienton studentët mbi karrieren dhe mundësitë e punësimit. Pjesëmarrjet në panairë si ai “Work & Study” u krijon mundësi studentëve për informim dhe mundësi punësimi, ndërsa nënshkrimet e marreveshjeve me institucione të ndryshme kanë ndihmuar studentët në praktikat profesionale, dhe shihen si mundësi tjetër për punësim të studentëve. <i>Evidenca II.21 Të dhëna Statistike nga zyra Alumni</i> <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-Tabela 23 të dhëna për diplomim dhe përfundim të studentëve</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Takimi me studentët, me personelin akademik të DPET-A dhe vëzhgimet në institucion konfirmojnë se studentët u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij procesi nëpërmjet; Ata ndiheshin të informuar mbi përditësimet, zhvillimet e ndryshme që lidhen me procesin mësimor dhe kjo realizohej nëpërmjet formave të ndryshme si komunikimi nga personeli akademik, drejtuesja e njësisë bazë, nëpërmjet komunikimit në postën elektronike të studentit, faqes online të UGJ, etj. <i>Vizita në institucion</i> <i>RVB</i>

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, pikërisht në përmbajtjen e Nenit 22 pika 2 gërma a, b theksohen format e sigurimit të informacionit në lidhje me programin MP në “Turizëm”. Gjithashtu ai realizohet edhe përmes komunikimit me postën elektronike të studentit dhe pedagogut. Informacioni bëhet lehtësisht i arritshëm edhe nga studentët në distancë. RVB Vizita në institucion ëëë.uogj.edu.al, https://uogj.pitagora.rash.al/login			
Konkluzione	UGJ, DPET-A vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit MP në “Turizëm”, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit prej këtij program. GVJ konstaton përmbushje plotësisht të standardit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues, GVJ kontaton se UGJ disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve, në programin e studimit MP në “Turizëm”. Nga vrojtimi vërehet se studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e pare <i>Aneks-Tabelat PËRMBLEDHËSE tab. 21</i> , sipas viteve janë: a) 13 studentë (2020-2021) b) 9 studentë (2021-2022) c) 10 studentë (2022-2023) Ndërsa studentë të diplomuar sipas viteve akademike janë si vijonë: a) 6 studentë (2020-2021) b) 11 studentë (2021-2022)

	c) 6 student (2022-2023)
	<i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE _tab. 23</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konstaton se UGJ disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve MP në "Turizëm". <i>Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaton se ndërveprimi midis sekretarisë mësimore dhe studentëve të pamatrikulluar duhet të jetë më intensive ne kohe, me qëllim finalizimin e rezultetit procedural. Kujdes duhet treguar në simbolikën e përdorur nga sekretaria mësimore.</i> <i>Evidenca I.14 Raport vjetor UGJ viti akademik 2019-2020</i> <i>Evidenca I.14.2 Raport vjetor UGJ viti akademik 2020-2021</i> <i>Evidenca I.14.4 Raport vjetor UGJ viti akademik 2021-2022</i> <i>Vizita në institucion, vizita në sekretarinë mësimore</i> ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konfirmon se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm Pitagora dhe më herët sistemi ESSe3. Gjithashtu, të dhënat ruhen manualisht në regjistrat përkatës, duke u menaxhuar nga Sekretaria mësimore. Të dhënat aksesohen nga personat e autorizuar; sigurohen dhe ruhen në bazë të rregulloreve dhe akteve ligjore në fuqi. <i>Evidenca V.1 rregullore për mbrojtje përpunim, ruatje dhe sigurinë e të dhënave personale</i> RVB <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe	Referuar RVB dhe dokumentacionit shoqërues GVJ konstaton se, UGJ mbështet me akte ligjore kontrollin periodik të dokumentacionit pranë Njësive bazë, Njësive kryesore dhe Sekretarive mësimore, dokumenton gjëndjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit, që lidhet me studentët si dhe me veprimtaritë e tyre. GVJ konstaton realizimin nga ana e UGJ të kontrollit gjatë vitit

dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	2022 (periudha e kontrolli: 31.01.2022-04.02.2022) me një strukturë të mirëpërcaktuar dhe raportohet gjendja nga kontrolli i kyer. <i>GVJ rekomandon zbatueshmërinë e përvitshme të kontrolleve të tilla për të gjitha njësitë përgjegjësie.</i> <i>Evidenca V.13 Rregullore e punës me dokumentet në UGJ</i> <i>Evidenca IV.10 Kontroll dokumentacioni Janar-Shkurt 2022</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstaton se njësia bazë harton raporte analitike mbi programin mësimor dhe plotësimin e objektivave mësimore të tij. Gjithashtu ajo raporton mbi cilësinë e hyrjes dhe daljes së studentëve dhe punësimin e tyre. Raportohen statistikave e punësimit brenda dhe jashtë profilit të studimeve të programit MP në “Turizëm”. Raportet janë të hartuara vetëm në nivel IAL-je jo në nivel njësie kryesore apo njësie bazë. GVJ sygjeron hartimin e raporteve në nivel Njësie kryesore dhe njësie bazë. <i>RVB</i> <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE</i>			
Konkluzione	<i>UGJ mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Dokumentacioni mbështetësh paraqitet i bollshëm dhe detajues dhe mbulon kriteret. GVJ sygjeron një vëmendje më të madhe të UGJ lidhur me kontrollet periodike të njësive institucionale dhe aspekteve administrative të sekretarisë mësimore gjatë procesit të matrikullimit. Gjithashtu njësia kryesore dhe njësia bazë duhet të përpilojnë raporte periodike lidhur me aktivitetin e tyre dhe të programit të studimit MP në “Turizëm”. Standarti përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e

këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UGJ ka përcaktuar hapësirat e nevojshme mbështetur në Statutin e tij, për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Kështu Neni 88, pika 1, gërma b, i Statutit të UGJ, përcakton se studentët kanë të drejtë të: “Përfaqësohen në organet kolegjiale të UGJ-së në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe më këtë statut”, ndërsa gërma f, u jep atyre të drejtën që të organizohen për çështjet e tyre në nivel institucional, njësie kryesore apo njësie bazë. Bazuar në statut (neni 91), studentët mund të organizohen në organizmat e tyre, të cilat janë të pavarura dhe nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe partiake. GVJ konstaton se ata janë pjesë e Senatit Akademik të UGJ (masa 10% e përfaqësimit), Këshillit të Etikës (1 student), NJSBC (1 student), këshillat studentor, komisionet zgjedhore institucionale, dhe janë anëtarë të GVB. Janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë Shoqatën Sportive Studentore. Gjatë vizitës në UGJ, GVJ konfirmoj faktet e mësimpërme. <i>Evidenca I.1 Stauti I UGJ</i> <i>Evidenca II.27.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik,</i> <i>Vizita në institucion, Takimi me studentët</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Pjesëmarrja dhe përfaqësimi institucional i studentëve, u krijon atyre mundësi të shprehen mbi procesin akademik (për planet mësimore, programet e studimeve, rregulloret e studimeve, etj) dhe të ndikojnë në vendimmarrje si psh: në cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, në zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, në ndarjen e burimeve financiare. Ata marrin pjesë si anëtarë në komisionet zgjedhore institucionale. Si dhe janë anëtarë të GVB për Akreditimin. Mendimet e tyre janë shumë të rëndësishme për institucionin dhe pyetësorët institucionale shërbejnë si mekanizma të tjerë për t'i vjelë mendimet e tyre me qëllimin për reflektime në vendimmarrje. <i>Evidenca I.1 Stauti I UGJ</i> <i>Evidenca II.27.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik,</i>

	<i>Evidenca V.3 Rregullore e zgjedhjeve 2020</i> <i>Evidenca II.28 Statuti i këshillit studentor</i> <i>Evidenca V.4. V.4.1 Urdhër për ngritjen e GVB</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	DPET-A në mbështetje të Statutit të UGJ, garanton që studentët të shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve; për rregulloret, veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të studimit, kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Një formë e mbledhjes së mendimeve të tyre, janë diskutimet me ta, ajo e realizimeve të pyetësorëve me studentët, ku analiza dhe raportimi i tyre (në raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorit) i vjen në ndihmë DPET për përmirësime dhe ndërmarrjen e vendimeve konkrete. Një pyetësor i tillë mbi cilësinë e mësimin online është zhvilluar gjatë vitit 2022. <i>Evidenca I.1 Stauti I UGJ</i> <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE,</i> <i>Evidenca III.5 Pyetësor Studentor</i> <i>Evidenca III.6 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ konfirmon se studentët kanë mundësi të informohen dhe të japin mendimin mbi kryerjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Ata sqarohen në fillim të vitit rreth formave të vlerësimit dhe mundësisë për tu përfshirë në procesin e ankimimit të rezultatit nga studenti. Madje procedurat janë të mirepërcaktuara në rregulloret e institucionit. GVJ evidenton procedurën e një ankese. Ajo bëhet me shkrim brenda afatit të ankimimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Dekani gjykon për ankesën e studentit nëse është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në rast se gjykohet e drejtë, atëherë me propozim të Përgjegjës të Departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënien e provimit nga student. <i>Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në universitetin "Eqerem Çabej" neni 46, pika 2</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e univeristetit "Eqerem Çabej,</i> <i>Evidenca II.6 Rregullore e FE</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se UGJ përfshin dhe angazhon studentët në

	<i>organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit MP në "Turizëm", metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Standarti përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka njësi të posaçme në shërbim të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Këto njësi ndihmojnë studentët për nevojat dhe paqartësitë e tyre lidhur me programin e studimeve që ato ndjekin. Funksionet informuese dhe ndihmuese të studentëve i kryen Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe Studentore (SSHBAS), pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative (DSHNA-A) e cila është në varësi të rektorit të UGJ. Ndërsa Zyra Juridike, u jep ndihmë punonjësve dhe studentëve për sqarimin e problemeve me karakter juridik. Për çështjet e këshillimit të studentëve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, realizmin e bursave jashtë shtetit të kuadër të marrevëshjeve ndërshtetërore apo ndëruniversitare sipas programeve të bashkepunimit, ku UGJ merr pjesë, u vjen në ndihmë, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni (ZKKA), nëpërmjet zyrës së Alumnit, këshillimit të karrierës dhe vlerësimit të vazhduar. Mbështetës të studentëve në informimin e tyre, janë dhe DPET, Sekretaritet mësimor, Sistemi elektronik Pitagora, Zyra e IT, etj. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi mbështetjen institucionale të këtyre njësive dhe gjatë takimit me studentët. <i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ, Neni 41.</i>

	<i>Evidenca IV.9 Rregullore e DSHNA Neni 6, pika 4, gërma j.</i> <i>Evidenca IV.9 Rregullore e DSHNA Neni 14. Neni 17, pika 7</i> <i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ neni 42, Neni 43, Neni 44</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UGJ, DPET ka siguruar mbështetjen e studentëve ndaj kërkesave të tyre mbi çështje të procesit mësimor dhe programit të studimit. Kjo veprimtari është e mirërregulluar në aktet rregulluese: Rregullore e Njesisë Bazë, Rregullore e Programit të Studimit (Neni 22 - Informimi i studentëve cilëson format e informimit), Rregullore e Sekretarisë Mësimore (administron dokumentacionin e procesit mësimor parashikuar në nenin 101 të ligjit 80/2015). Drejtuesi dhe personeli akademik i programit të studimit MP në “Turizëm” në DPET, informojnë studentët mbi përparimin e tyre dhe çështjet që lidhen me procesin mësimor, ndërsa Sekretaria mësimore mbështet me dokumentat e arkivuar dhe nevoja të tjera të natyrës arkive-sekretari që lidhen me këtë marrëdhënie. Gjatë vizitës në institucion, takimin me studentët dhe personelin akademik të programit, studentët konfirmuan mbështetjen nga personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe organet drejtuese. Një pjesë të informacionit dhe këshillimit nga: ZKKA, sistemi elektronik Pitagora, rrjetet zyrtare sociale, faqja online e UGJ. <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit ët Studimit Master Profesional në Turizëm,</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Vizita në institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun	ZKKA (Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit) është njësia e cila këshillon studentët mbi karrierën në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, informacion për programet dhe kurrikulat e studimeve, orinetimet në tregun e punës. Mundëson informacione të mundshme të studentëve të ciklit Bachelor mbi mundësitë e studimeve në nivelin e dytë, gjatë të cilës janë të mundur praktikat profesionale. ZKKA e organizon veprimtarinë e saj në bazë të aktiviteteve, ku për secilin prej tyre përcaktohen objektivat, personat përgjegjës, grupi i interesit dhe afati kohor. Natyra e aktiviteteve për vitin 2022-2023 janë të natyrës: Info tour, informimi i aktiviteteve mbi karrierën në rrjete sociale, hartimi i CV dhe intervistave, takime të hapura, konferencë

e punës.	studentore, mundësi publikimi, trajnime mbi aftësitë komunikuese, takime me studentët e diplomuar, Panairi i punës, etj. <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 42,</i> <i>Evidenca V.6 Rregullore DSHNA-A, Neni 14,</i> <i>Evidenca II.25 Plani vjetor i KKA 2022-2023.</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	ZKKA në UGJ, përcakton në planin e saj vjetor gjurmimin e studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë në dispozicion të organeve drejtuese përkatëse. Këto të dhëna janë të pasqyruara në <i>ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabela 23</i>. Gjatë aktiviteteve të panairit të punës nëpërmjet procedurave të gjurmimit të studentëve merret vlerësimi mbi impaktin e njohurive të fituar në programin e studimit dhe vënien në zbatim të tyre. <i>Evidenca II.25 Plani vjetor i KKA 2022-2023.</i> <i>Evidenca II.26 formular kontakti</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UGJ, ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Ky standart përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UGJ ka hartuar një udhëzues në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies, miratuar nga Senati Akademik me vendim Nr.28, datë 28.09.2023, Megjithëse e hartuar së fundi, SSKC (Sektor i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave) e ka miratuar udhëzuesin mbështetur në qasjen e mësimdhënies me bazë studentin. Në të paraqiten orientime për metoda konkrete të mësimdhënies të cilat rekomandohen të përdoren nga personeli akademik sipas specifikave lëndore. Gjatë takimit në institucion me personelin akademik dhe studentët të programit të studimit MP në Turizëm GVJ konstaton se ata përdorin gjatë procesin mësimor, qasje didaktike të përditësuara bazuar në specifikat lëndore, si psh përdorimi i aplikacioneve dhe teknologjive mësimore. Ndërsa për vitin 2020-2021, nën nevojat e situatës së pandemisë COVID-19, personeli akademik ka përdorur platformat e mësimin në distancë, si Google Classroom, Zoom, Skype, Office 365, sistemi Pitagora. <i>RVB</i> <i>Evidenca III.4 Udhëzues institucional për përdorimin e metodave innovative në mësimdhënie</i> <i>Evidencat III.1-5 Manualët dhe implementimi i platformave të ndryshme</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	SSKC (Sektor i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave) është stuktura e cila ka të përcaktuar qartë në Statutin e UGJ, ndër të tjera (Nenin 94, pika 5, gërma d, f, g) se: (d) kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore-shkencore, si dhe të aspekteve të tjera të lidhura me to; (f) planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, si dhe të vlerësimit të brendshëm

institucional; (g) në fund të cdo semestri organizon pyetësor studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e cdo program studimi. UGJ ka realizuar një pyetësor gjatë periudhës 11 Prill – 2 Maj 2022, mbi cilësinë e mësimdhënies online për vitin 2020-2021. Gjithashtu UGJ organizon kontrole të vazhdueshm, lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog (programet përkatëse të lëndëve, regjistrat etj), për një ecure sa më normale të gjithë procesit mësimor dhe shkencor, dokumentuar në raportet vjetore të UGJ dhe FE.

Bazuar në dokumentacionin bashkeshoqërues GVJ konstaton se vlerësimi në bazë të pyetësorëve studentor nuk realizohet periodikisht sipas përcaktimeve të statutit të UGJ.

Në UGJ funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e ngritur qysh në 2020, strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë. Ka një rregullore për funksionimin e saj, por GVJ konstaton se bazuar në dokumentat bashkeshoqërues nuk eidentojnë përmbushjen e këtij kriteri. *Manuali i Cilësisë në UGJ të cilën NJSBC e përdor në funksionalitetin e saj, konstatohet që është miratuar me Vendim të Senatit Akademik në dt 28.09.2023 duke eidentuar mungesë të mbështetjes së punës se kësaj strukture në këtë manual në tre vitet e fundit.*

Në raportet vjetore të FE ku DPETA nuk cilësohen mekanizmat e përdorur nga departamenti mbi monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

Evidenca III.19

Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC

Evidenca VI.1 Manuali i Cilësisë në UGJ

Evidenca V.6 Rregullore për funksionimin e DSHNA

Evidenca I.14 Raport vjetor i UGJ viti akademik 2021-2022

Evidenca I.14.10 Raport vjetor i veprimtarise mesimore-kerkimore te FE 2021-2022

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Pavarësisht kufizimit të shprehjes mendimeve të studentëve nëpërmjet pyetësorëve studentore (jo periodike), GVJ gjatë vizitës në institucion, në takimin me studentët konkludoi se, nëpërmjet përfshirjes së tyre në organet institucionale universitare përcjellin vlerësimet e tyre, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, mbi performancën e personelit akademik, syllabuseve dhe programit mësimor, përfshirë procesin mësimor. <i>GVJ rekomandon realizimin periodik të pyetësorëve me tematike mbi format e vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajnimit dhe ankimeve.</i> <i>Evidenca 1 Statuti i UGJ</i> <i>Evidenca V.4.1 Urdhër për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit MP në Turizëm NJBPET</i> <i>Evidenca 3 rregullore e studimeve</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ kontston se rezultatet e vlerësimit mbi monitorimin dhe sigurimin e cilësisë paraqiten në raporte ku evidentohen gjetjet si psh raporti i pyetësorit të organizuar gjatë periudhës 11 Prill – 2 Maj 2022, mbi cilësinë e mësimdhënies online për vitin 2020-2021. Rezultatet u bëhen të qarta njësisë bazë, gjetjet e të cilëve i diskutojnë në mbledhjet e departamentit duke vënë në dijeni personelin akademik. <i>GVJ rekomandon monitorim të vazhdueshëm lidhur me çështjet e sigurimit të cilësisë në mësimdhënie dhe bërjen e gjetjeve të tyre sa më publike jo vetëm në raportet e njësisë kryesore dhe asaj bazë, por dhe për një publik më të gjerë të interesuarish, në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i> https://uogj.edu.al/transparenca, <i>Evidenca III.6 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor</i> <i>Evidenca I.14 Raport vjetor i UGJ viti akademik 2021-2022</i> <i>Evidenca I.14.10 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kerkimore të FE 2021-2022</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit	UGJ, nëpërmjet të dhënave që disponon SSCK dhe raporteve vjetore të këtij sektori ka synuar përmirësimin e veprimtarisë mësimore dhe të kërkimit shkencor të personelit akademik. Veprimtaria e NJSBC është e zbehtë. Mbështetur në RVB dhe gjatë vizitës në institucion në takimin me përfaqësues të NJSBC u

personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<i>theksua intensifikimi i punës së NJSBC në vitet në vazhdim. GVJ rekomandon strukturimin e mekanizmave të vlerësimit.</i> <i>Evidenca VI. 3 Raport I vlerësimit të cilësive dhe kurrikulave 21-22.pdf</i> <i>Evidenca VI.3.1 Raport I vlerësimit të cilësive dhe kurrikulave 20-21.pdf</i> <i>Evidenca I.14.10 Raport vjetor i veprimtarisë mesimore-kerkimore të FE 2021-2022</i>			
Konkluzione	<i>UGJ ka hartuar dokumenta rregullatorë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies; ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të mësimdhënies me në qendër studentin si dhe manualin e cilësisë. Këto dokumenta janë hartuar dhe publikuar duke i ardhur në ndihmë institucionit në vitet në vazhdimësi. GVJ sygjeron realizimin e procesit të monitorimit në mënyrë periodike dhe të tematizuar sipas natyrës së programit të studimit. Standarti përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në mbështetje të Nenit 103 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, UGJ ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. (SBC). Struktura, funksionimi i NJSBC (7 anëtarë) dhe i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) përcaktohen në Statutin e UGJ, Strategjinë e Institucionit 2020-2025, Rregulloren e UGJ, Statutin dhe Rregulloren NJSBC. SSCK është pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative në varësi të Rektorit të UGJ. Në Statut dhe në Rregulloren e NJSBC, përcaktohen qartë gjithashtu politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të

	Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. <i>Por miratimi i kësaj njësie (NJSBC) është realizuar në dt 28.09.2023, me Vendimin e Senatit Akademik Nr.24. dt 28.09.2023.</i> <i>Nga hulumtimi i dokumentacionit bashkëlidhur GVJ konstaton se vlerësimi periodik i veprimtarisë mësimore dhe asaj kërkimore shkencore realizohet nga SSCK si struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjithë njësitë përbërëse dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standartet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.</i> <i>Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC.f</i> <i>Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave Rregullore e NJSBC.f</i> <i>Evidenca VI.3.2 Plan vjetor i Sektorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave Rregullore e NJSBC.f</i> <i>Evidenca I.1 Statuti i UGJ, Neni 93-94</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin bashkëshoqërues UGJ dëshmon se funksionimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë mbështetet në veprimtarinë e SSCK e cila është ngritur dhe funksion në bazë të planifikimeve të saja vjetore. Ndërsa NJSBC është e ngritur së fundmi dhe funksionaliteti i saj do të vlerësohet në vijmësi. Mbështetur në RVB dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se: <i>“Institucioni po punon për ngritjen dhe forcimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si një nga objektivat e Strategjisë së Institucionit 2020-2025. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet SSCK. Kjo Zyrë bashkëpunon dhe asiston komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore.”</i> Studentët përfshihen në vendimarrje për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë nëpërmjet përfaqësimit në organizma institucional. Ndërsa ekspertët e jashtëm mund të anagazhohen në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, për çështje të fushës së sigurimit të cilësisë.

	<i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC, Neni 3, Neni 4</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 93 – 96.</i> <i>Evidenca I.2 Startegjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidenca I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, Neni 103, Neni 104 i cili parashtron përgjegjësitë, mënyrat e vlerësimit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, nëpërmjet sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në IAL-e, UGJ-ja e kryen vlerësimin e brendshëm të cilësisë mbështetur në veprimtarinë e SSCK (Neni 93, Neni 94 Statuti i UGJ) dhe NJSBC (kjo e fundit organizuar së fundmi). Ndërsa sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë (Neni 104, Ligji Nr. 80/2015). UGJ i nënshtrohet procesit të vlerësimit, nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2019 dhe 2022, rezultatet e të cilit janë bërë publike prej ASCAL. Ajo ka kryer vlerësim periodik të institucionit brenda afatit kohor të vlefshërisë së tij dhe është në fazën e akreditimit të programeve të studimit: 1. Akreditimi i parë i UGJ shpallur me Vendim të BA Nr. 67, datë 21.09.2017, periudha: 21/09/2017 deri në 30/09/2020). 2. Vlerësimi periodik rezultuar me Vendim BA Nr. 55, datë 16.12.2021, periudha: 16/12/2021 deri në 15/12/2025. Në përmbushje të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit, UGJ ka hartuar një plan veprimi i cili është miratuar me Vendim Senati Nr.15. Dt 03.06.2022. Ky plan veprimi i është përcjell ASCAL. Plan i veprimit detajon respektivisht: rekomandimet e BA, masat konkrete që do të ndërmerren nga UGJ, strukturat përgjegjëse dhe afatet kohore. <i>Evidenca I.9.1 Miratim i planit të veprimit për rekomandimet e akreditimit</i> <i>Evidenca I.9.2 Plani i Veprimit</i> <i>Evidenca VI.2 Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm	UGJ nëpërmjet sektorevë të saj përdor tregues si psh: pyetësor institucional dhe raportimet periodike semestrale apo vjetore për

në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	të pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë të cilat parashtrohen në statut apo në rregullore. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se format e promovimit nxitës janë të ndryshme si psh: promovim në komunitetin rajonal gjatë javëve të informimit, krijimi i lehtësive në publikim në Buletin Shkencor të universitetit, mbështetje financiare në aktivitete shkencore si konferenca, simpoziume, përfshirja në projekte, përfshirja në organizimin e trajnimeve si trajnere, psh në trajnimet e organizuara nga Fakulteti i Edukimit etj. <i>Nga GVJ forma të tilla promovimi konsiderohen pozitive dhe promotore të nxitjes për arritje më të mira.</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 95 pika 5,</i> <i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC, SSCK</i> <i>Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave</i> <i>Evidenca VI.3.2 Plani vjetor i Sektorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave Rregullore e NJSBC.f</i>			
Konkluzione	<i>UGJ harton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Ajo ndërmerr realizimin e formave të ndryshme të promovimit të personelit akademik dhe përvojave të mira. Mbështetur në faktin që NJSBC-ja është njësi shumë e re GVJ rekomandon intensifikimin e veprimtarisë së saj me hapa konkret. Standarti përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale	Raportet periodike vjetore të FE (2020-2021; 2021-2022) janë mekanizma formale të cilat vlerësojnë në mënyrë periodike programin e studimit MP në Turizëm. Evidencimet e arritjeve,

e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	dobësive, gjetjet e ndryshme të paraqitura në të tij u bëhen pjesë e raporteve vjetore UGJ (2020-2021; 2021-2022). Ato janë pjesë e dokumentacionit të evidencave që shërbejnë për akreditimin e programit dhe për akreditim institucional. <i>GVJ konstaton se DPET-A nuk harton raporte vjetore periodike në të cilin të pasqyrohen analizat e treguesëve të zhvillimit të programit të studimit, arrijtjet, mangësitë dhe praktikat më të mira. Lidhur me këtë sygjerojmë të filloj procesi i hartimit të raporteve vjetore edhe për vetë programin e studimit MP në Turizëm.</i> <i>RVB</i> <i>Evidenca I.14- Evidenca I.14.14 Raporte vjetore UGJ, FE, NJBPET vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet vjetore të SSCK (2020-2021, 2021-2022) dhe raportet vjetore të DPET-A (2020-2021, 2021-2022) mundësojnë vlerësim mbi rezultatet e pritshme, evidentim të përfshirjes në praktiva nxitëse dhe kërkimit shkencor të personelit akademik. Raportet vjetore të DPET-A ka synuar të parqes informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së Departamentit në zbatim të misionit të tij, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; të prezantoj elemente që lidhen me shërbimet që DHAGJ ofron; dhe nxisë dhe të rris përgjegjësinë, llogaridhënies dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve që ofron Departamenti; të paraqes problemet e konstatuara nga Departamenti, me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit. I gjithë ky raportim mbështetet në aktet ligjor në fuqi, urdhëra dhe udhëzime të përditësuar. Pyetësoret me studentët, gjurmimi i punësimit të tyre dhe diskutimet në departament për të, plotësojnë analizat vlerësuese për rezultatet e pritshme mbi përmirësimin në vijim të cilësisë, motivimin në mësim dhe kërkim. <i>Evidenca I.14.12-I.14.14 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore kërkimore të NJBPET për vitet akademike 2019-2020,</i>

	2020-2021, 2021-2022
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Mbështetur në RVB, konstatohet se DPET-A në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit mbikqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të studimit, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera; ndjekin aktivitetin mësimor dhe shkencor të personelit akademik dhe vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seancave laboratorike, praktikave në terren, detyrave të ndryshme apo testimeve gjatë vitit akademik. Forma të tjera vlerësimi janë anketimi me studentët, diskutime të hapura, gjurmimi i ish studentëve etj. Gjetjet vihen në shërbim të raportimeve vjetore institutionale. <i>RVB</i> <i>Evidenca I.14.12-I.14.14 Raport vjetor mbi veprimtarine mësimore kërkimore të NJBPET për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të	Nga shqyrtimi i RVB ballafaquar edhe gjatë vizitës në institucion konstaton se, UGJ në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe dhe intervista të: studentëve dhe të diplomuarve; personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ; punëdhënësve dhe institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që shërbejnë për vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të përftuara nga ky program. Përmenden realizimi i pyetësorit studentor 2020-2021, evidentimet në planin vjetor të KKA (2022-2023), të dhënat mbi diplomimin dhe punësimin e studentëve etj. <i>RVB</i> <i>Vizita në institucion</i>

përfutuara nga ky program.				
Konkluzione	UGJ monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve. Ajo përdor instrumenta të ndryshëm si të dhëna nga raporte të ndryshme, anketime, diskutime me ish studentë, të dhëna nga gjurmimi i studentëve, etj. GVJ vlerësimon plotësisht përmbushjen e këtij standarti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UGJ në proceset e SBC të programit të studimit MP në Turizëm ka parashikuar përfshirjen e aktorëve të ndryshëm (personel akademik, personel ndihmësakademik, personel administrativ dhe studentët), për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Statuti i UGJ, Plani Strategjik i Zhvillimit 2020-2025, veprimtaria e SSCK, NJSBC, organizatat studentore, zyra e Alumnit, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar (si promovuese e programit të studimit), garantojnë politikat dhe procedura të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë së mesimdhënies angazhimit në kërkimin shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ. <i>RVB</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitet, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Të gjitha njësitet në UGJ, individët, studentët dhe palët e interesuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë i kanë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë në statutin e UGJ, dhe rregullore të ndryshme si: ajo e DSHNA-A, NJSBC, Rregullore e UGJ, e FE, dhe e njësive bazë. <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ</i>

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<i>Evidenca I.6 Rregullore e univeristetit "Eqerem Çabej,</i> <i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC, SSCK</i> <i>Evidenca V.6 Rregullore për funksionimin e DSHNA</i> <i>Evidenca II.6 Regullore e FE</i> <i>Evidenca II.13 Regullore e NJBPET</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin bashkëshoqerues GJV konstaton se anëtarët të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit përfshihen në organizma dhe procese të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit si psh janë pjesë e NJSBC, komisioneve të garantimit të cilësisë, kryerjen e anketimeve dhe dhenia e kontributeve të tyre në organizimet studentore etj. <i>RVB</i> <i>Evidenca II.13 Regullore e NJBPET</i> <i>Evidenca I.5 Regullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GJV konstaton se proceset e vlerësimit bazohen në integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Veprimtaria e UGJ, përfshirë dhe aktorët e brendshëm që aktivizohen në proceset ciklike të vlerësimit udhëhiqen nga parimet si vijon: Liria e mendimit dhe e shprehjes; Liria akademike, autonomia financiare, organizative dhe e perzgjedhjes së personelit; transparenca; meritokracia; kolegjaliteti; mosdiskriminimi. Gjithashtu aktorët e brendshëm të përfshirë në këto proceset e kanë të detyruar të respektojnë Kodin e Etikës së UGJ, ku në Kreun III, Neni 8 (Njohja e meritës) dhe Neni 9 (Ndalimi i diskriminimit), përcaktohet sesi Universiteti njeh dhe promovon meritën individuale si për personelin akademik ashtu dhe për studentët. Në të theksohet e drejta për tu trajtuar në mënyrë të barabartë, me mirëkuptim, respect, nderim; shmangjet e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, duke theksuar së është detyra e universitetit dhe e anëtarevve të tij (pra aktorëve të brendshëm) të inkurajojë iniciativat e drejtuara në mbrojtje dhe vlerësimin ekategorive të pafavorizuara, ndryshimin individual dhe kulturor. Gjatë vizitës në insitucion GJV konstatoi përmbushjen si: meritokracia në përfshirje në aktivitete shkencore, mbeshtetja financiare në zhvillimin profesional të stafit etj.

	<i>RVB</i> <i>Vizita në institucion, takimi me personelin akademik</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm konsiderohet i rendësishëm për UGJ dhe nënnjësitë e tij. Format e sigurimit të vlerësimit kundrejt programit të studimit dhe universitetit në tërësi janë të ndryshme, duke përmendur: veprimtarinë e SSCK dhe mundësisë së saj në angazhimin e ekspertëve të jashtëm për çështje specifike dhe/ose specialist të nivelit të lartë të fushës së sigurimit të cilësisë. <i>Nuk evidentohet/dokumentohen raste konkrete për pjesëmarrje aktive të ekspertëve të jashtëm për programin e studimit MP në "Turizëm".</i> Gjithashtu vlerësohet pozitivisht pjesëmarrja në panairin "Work and Study", pasi nëpërmjet takimeve me punëdhënësve publik dhe privat, si të interesuar për rekrutim në punësim, kuptohet realisht raporti mbi nevojat e tregut dhe atë cfarë program dhe universiteti ofron. Nëpërmjet takimeve të tilla vlen mendime të rëndësishme në lidhje me cilësinë e programit dhe shihen mundësitë e përmirësimit të saj; ndërsa studentët kanë mundësi të konsolidojnë praktikisht njohuritë lëndore të fituara gjatë viteve të studimeve universitare. <i>Në mbështetje të proceseve vlerësuese, GVJ sygjeron që bashkëpunëtorët dhe/ose ekspertët e jashtëm të mund të sigurohen nga institucionet publike dhe jopublike, më të cilat UGJ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe që operojnë në fushat e programit të studimit MP në "Turizëm".</i> <i>RVB</i> <i>Evidenca I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në UGJ</i>
Konkluzione	<i>UGJ perfshin njësitë akademike, si SSCK, zyra e Alumnit, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, DHAGJ, personeli akademik e studentët, partnerë në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Në mbështetje të proceseve vlerësuese, GVJ sygjeron që bashkëpunëtorët dhe/ose ekspertët e jashtëm të mund të sigurohen nga institucionet publike dhe jopublike, më të cilat UGJ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe që operojnë në fushat e programit të studimit MP në "Turizëm". Proceset e vlerësimit bazohen në integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie</i>

	<i>kundrejt personelit dhe studentëve. GVJ konstaton përmbushjes plotësisht së standardit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me studentët, si dhe duke hulumtuar faqen zyrtare elektronike të UGJ, GVJ konstatoi se në kuadër të transparencës UGJ bën transparente politika, organizime dhe veprimtaritë në universitet përfshi dhe të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të institucionit, nënjësive të tij dhe më pak të programit të studimit (program i studimit Histori-Gjeografi) http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/feshsh-departamente/departamenti-i-histori-gjeografise/. Një seksion i vecantë i faqes online i është kushtuar transparencës: mbi akreditimin (informacion mbi NJSBC, Akreditimin institucional dhe Kodin e Cilësisë), zgjedhjet në universitet, raporte të auditit dhe buxhetit, njoftime punësimi dhe programi i transparencës. Studentët shprehën së bërja publike e informacioneve dhe krijimi i mundësisë për të aksesuar informacione në kohe reale lidhur me programin e studimit ka krijuar një facilitet të nevojshëm për ta. Infomacioni në nivelin e studimeve të ciklit të parë është i kufizuar http://ëëë.uogj.edu.al/upload/plan%20programet/Bachelor%20ne%20Histori%20Gjeografi.pdf Megjithëse publikimet bazohën në Statut, Rregullore, vendime të Senatit Akademik, GVJ sygjeron pasurimin e informacioneve konkrete për studentët dhe të interesuarit, në nivel të njësisë bazë. <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 60; https://uogj.edu.al</i> <i>Evidenca VI.5 Vendim Senati për miratimin e programit të transparencës 2023 i rishikuar</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon	GVJ konstaton se UGJ harton disa lloje raportesh si: Raport i pyetësorit për procesin e mësimi online Prill-Maj 2022; Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Plan vjetor i Sektorit të

rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023; <i>por publikimi i tyre është i kufizuar ose mungon.</i> http://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/ Raportet respektojnë lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Publikimet respektojnë lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Evidenca III.5 Pyetësor Studentor</i> <i>Evidenca III. 6 Rport mbi rezultatet e pyetësorit studentor</i> <i>Evidenca III. 9 Kodi i Etikës</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pas marrjes së vendimit të Akreditimit Periodik Institucional, UGJ ka hartuar një plan veprimi/ masash në të cilën janë paraqitur veprimi, kush është përgjegjësi për monitorim dhe zbatim dhe koha e realizimit. (<i>Evidenca 1.9.2 Plan veprimi në kuadër të rekomandive të akreditimit</i>). Ato synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit e mësimdhënies si dhe mangësive të evidentuara.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	SSCK ka vlerëson periodikisht duke hartuar raportet vjetore, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të UGJ. Edhe rekomandimet e lëna institucionit në kuadër të akreditimit institucional kanë shërbyer për përmirësimin e cilësisë së punës dhe ofrimit të shërbimeve dhe janë plotësuar nga institucioni. <i>RVB. Evidenca VI.3, Evidenca VI.3.1 Evidenca VI.3.2</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmon se UGJ nëpërmjet Njesisë Bazë organizon takime, aktivitete, seminare informuese, ëorkshop-e me studentët, për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me impaktin e studentëve në përmirësimin e cilësisë së programit si dhe shërbimeve administrative në institucion, aktivizim në pyetësorë, pjesëmarrje në

studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Sondazhin Kombëtar të Studentëve etj. <i>Evidenca I.1. Statuti i UGJ, Neni 60</i>			
Konkluzione	<i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë pjesërisht publike, Ato janë transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë, por ato duhet të jenë më tepër përfaqësuese për programin e studimit. GVJ konstaton përmbushjen kryesisht të standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Turizëm” ofruar nga Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”

Pikat e forta dhe afirmimet

1. Institucioni UGJ garanton mjedise të përshtatshme për punë laboratorike, për realizimin e praktikës duke bashkëpunuar me institucione të tjera. [(Standardi I.3; Konkluzione)]
2. Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke synuar zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. [Standardi III.4; Konkluzione]
3. Ngarkesa mësimore e programit të studimit Master Profesional në “Turizëm” mbulohet gati në masëm 100% nga personelit akademik efektiv DPET duke grantuar qëndrueshmëri të programit. [Standardi IV.1; Kriteri 2]

4. Programi i studimit Master Profesional në “Turizëm” garanton formimin e profesionistëve konkurues në fushën e turizmit duke i bërë studentët të aftë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. [Standardi II.7; Kriteri 4]
5. Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore. [Standardi II.6; Konkluzione]

Pika të dobta

1. Programi i studimit nuk ka ngjashmëri me programe të njëjta të cilat ofrohen brenda dhe jashtë vendit duke vështirësuar procesin e shkëmbimit të studentëve dhe njohjen e diplomës jashtë vendit. [Standardi II.1; Konkluzione]
2. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Turizëm” raporton mungesë mbështetje financiare për kërkimin shkencor. [Standardi II.6; Konkluzione]
3. Plani mësimor reflekton mosrespektim të normave të shpërndarjen së sasisë së krediteve për kategoritë lëndore, sipas përcaktimeve të VENDIMIT Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. [Standardi III.1; Konkluzione]
4. Programi i studimit Master Profesional në “Turizëm” nuk ka një koordinator i cili të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit. [Standardi II.2; Konkluzione]

Rekomandime

1. Të rishikohet përmbajtja e programit të studimit me qëllim që programi të jetë i ngjashëm me programe të tjera të cilat ofrohen brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që të lehtësohet shkëmbimi i studentëve dhe njohja e diplomës jashtë vendit. [Standardi II.1; Konkluzione]
2. Të caktohet një koordinator i cili të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit. [Standardi II.2; Konkluzione]
3. Të rishikohet shpërndarja e ngarkesës në kredite për çdo kategori lëndore dhe respektimin e shpërndarjes së përqindjeve në përputhje me normat e përcaktuara në aktet ligjore të sipër cituara. [Standardi III.1; Konkluzione]
4. UGJ të intensifikoj kontrollet periodike të punës së sekretarisë mësimore gjatë procesit të matrikullimit të studentëve me qëllim që të mos lejoj frekuentimin e programit nga studentët pa numër matrikulli, për një kohë të gjatë, për arsye të ndryshme. [Standardi V.4; Konkluzione]
5. Të përpilohen raporte periodike lidhur me aktivitetet që zhvillohen në kuadër të zhvillimit të programit të studimit MP në “Turizëm”, nga njësia kryesore dhe njësia bazë. [Standardi V.4; Konkluzione]
6. Të rritet fondi i investimeve për blerjen e teksteve dhe literaturës në fushën e turizmit, veçanërisht në gjuhë të huaj. [Standardi IV.4; Konkluzione]
7. UGJ të realizoj procesin e monitorimit në mënyrë periodike dhe të tematizuar sipas natyrës së programit të studimit MP në “Turizëm”. [Standardi VI.1; Konkluzione]

8. Të intensifikohet veprimtaria e NJSBC-së me hapa konkret. [Standardi VI.2; Konkluzione]
9. Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë duhet të jenë më teper përfaqësuese për programin e studimit. [Standardi VI.5 Konkluzione]

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Tourism" provided by the Higher Education Institution University of Gjirokastra "Eqrem Cabej"

Strengths and affirmations

1. The UGJ institution guarantees suitable environments for laboratory work, for the implementation of practice by cooperating with other institutions. (Standard I.3; Conclusions)
2. The study program guarantees the growth of creative and implementation skills among students, aiming at the in-depth development of professional and scientific competencies among students. (Standard III.4; Conclusions)
3. The teaching load of the Professional Master's study program in "Tourism" is covered almost 100% by the effective DPET academic staff, granting sustainability of the program. (Standard IV.1; Criterion 2)
4. The Professional Master's study program in "Tourism" guarantees the formation of competitive professionals in the field of tourism, making students capable of the national and international labor market. (Standard II.7; Criterion 4)
5. Involvement of students in research activities. (Standard II.6; Conclusions)

Weaknesses

1. The study program has no similarities with the same programs that are offered inside and outside the country, making the process of student exchange and the recognition of the degree abroad difficult. (Standard II.1; Conclusions)
2. The academic personnel engaged in the Professional Master's study program in "Tourism" report a lack of financial support for scientific research. (Standard II.6; Conclusions)
3. The teaching plan reflects non-compliance with the norms of distribution of the number of credits for subject categories, according to the determinations of DECISION No. 41, dated 24.1.2018 ON THE ELEMENTS OF STUDY PROGRAMS OFFERED BY INSTITUTIONS OF HIGHER EDUCATION. (Standard III.1; Conclusions)
4. The Professional Master's study program in "Tourism" does not have a coordinator who is responsible for the progress and development of the program. (Standard II.2; Conclusions)

Recommendation

1. To review the content of the study program in order for the program to be similar to other programs that are offered inside and outside the country in order to facilitate the exchange of students and the recognition of the degree abroad. (Standard II.1; Conclusions)

2. To appoint a coordinator who will be responsible for the progress and development of the study program. (Standard II.2; Conclusions)
3. To review the distribution of the load in loans for each subject category and the observance of the distribution of percentages in accordance with the norms defined in the aforementioned legal acts. (Standard III.1; Conclusions)
4. UGJ to intensify the periodic controls of the work of the teaching secretariat during the student registration process in order not to allow the attendance of the program by students without a registration number, for a long time, for various reasons. (Standard V.4; Conclusions)
5. To compile periodic reports related to the activities carried out in the framework of the development of the MP study program in "Tourism", from the main unit and the basic unit. (Standard V.4; Conclusions)
6. To increase the investment fund for the purchase of texts and literature in the field of tourism, especially in foreign languages. (Standard IV.4; Conclusions)
7. UGJ to carry out the monitoring process periodically and themed according to the nature of the study program MP in "Tourism". (Standard VI.1; Conclusion)
8. To intensify the activity of NJSBC with concrete steps. (Standard VI.2; Conclusions)
9. Internal Quality Assurance policies, processes and activities should be more representative of the study program. (Standard VI.5 Conclusions)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X